

RAPORT
I VLERËSIMIT TË JASHTËM
NË KUDËR TË AKREDITIMIT PERIODIK
Për Programin e studimit BSc PSikologji
Kolegji Universitar “WISDOM”

Ekspert i vlerësimit të jashtëm:

Dr. Anila Sulstarova



Qershor 2017

RAPORT I GRUPIT TË VLERËSIMIT TË JASHTËM

Për Programin e studimit BSc në "Psikologji"

Tabela e të dhënave për programin e studimit		
1	IAL Aplikues:	Kolegji Universitar "WISDOM"
2	Fakulteti që e ofron	Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore
3	Urdhëri/VKM i licencimit/riorganizimit	VKM Nr. 254, datë 27.02.2008
4	Urdhëri/VKA e Akreditimit të parë	Urdhër Nr. 188, datë 25.04.2011
5	Titulli i programit të studimit:	Bachelor në Psikologji
6	Cikli i studimit:	Cikli i parë
7	Kohëzgjatja e programit të studimit:	3 vite
8	Kreditet në total (ECTS):	180 ECTS
9	Forma e studimit (me kohë të plotë/të pjesshme/në distancë/):	Me kohë të plotë
10	Gjuha (shqip/tjetër):	Shqip
11	Programi ofrohet nga institucioni	Po
12	Programi ofrohet në bashkëpunim me institucione të tjera	-
13	Diplomë e përbashkët (shëno emërtimin):	-
14	Diplomë e dyfishtë (shëno emërtimin):	-
15	Niveli në Kornizën kombëtare të kualifikimeve	6
16	Numri i studentëve për program studimi	150

Shënim:

Verifikimi ligjor sipas pikave si më sipër kryhet paraprakisht nga specialist/ët e APAAL që ndjekin këtë vlerësim

HYRJE

Të dhëna për programin e studimit Bachelor në Psikologji të ofruar nga Kolegji Universitar "WISDOM".

(Të dhëna zyrtare për hapjen e programit të studimit, miratimine hapjes, akreditimin e parë, etj.)

Kolegji Universitar "WISDOM" është licensuar me Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 672, datë 27.9.2006, "PËR DHËNIEN E LEJES PËR HAPJEN E SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE, JO PUBLIKE " WISDOM UNIVERSITY" Shkolla e Lartë Universitare Jopublike " Wisdom University" është akredituar me Urdhër Nr. 237, datë 09.05.2016. Me urdhër Nr. 145, datë 31.03.2017 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit, "PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË KOLEGJIT UNIVERSITAR "WISDOM", ndryshon emërtimi i institucionit nga Shkolla e Lartë Jopublike "Wisdom University" në Kolegji Universitar "WISDOM"

Programi i studimit bachelor në Psikologji është licensuar me VKM, Nr. 254, datë 27.2.2008, në formën e studimeve me kohë të plotë, me kohëzgjatje 3 vite. Në përfundim të këtij programi studimi lëshohet diploma "Bachelor" në fushën e arsimit të kryer. Programi i studimit Bachelor në Psikologji është akredituar me Urdhër të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 188, datë 25.04.2011, mbështetur në Vendimin Nr. 150, datë 18.02.2011, të Këshillit të Akreditimit .

Pas akreditimit të programit "Bachelor" në Psikologji, në përputhje me kërkesat ligjore, por edhe me kushtet e plotësuar, nga ana e Kolegji Universitar "WISDOM", është bërë riorganizimi i plotë organizativ i institucionit. Ky riorganizim është miratuar me Urdhërin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 412, datë 25.08.2011, mbështetur në Vendimin Nr. 214, datë 29.07.2011 të Këshillit të Akreditimit.

Sipas këtij organizimi, SHLUJ "WisdomUniversity" përbëhet nga:

1. Fakulteti i Drejtësisë me njësitë bazë:

- 1.1 Departamenti i të Drejtës Publike
- 1.2 Departamenti i të Drejtës Private
- 1.3 Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore me njësitë bazë:

- 2.1 Departamenti i Psikologjisë
- 2.2 Departamenti i Ekonomisë
- 2.3 Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve

Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional me Urdhër Nr.237, datë 09.05.2016. "PËR PLOTËSIMIN E KUSHTEVE PËR AKREDITIMIN INSTITUCIONAL TË SHKOLLËS SË LARTË UNIVERSITARE JOPUBLIKE "WISDOM UNIVERSITY", TË VENDOSURA NË URDHËRIN NR.355,DATË 25.09.2015, PËR AKREDITIMIN INSTITUCIONAL ME KUSHT TË SHLUJ "WISDOM UNIVERSITY".

Kolegji Universitar "Wisdom", ka sjellë në ASCAL me shkresë Nr. 108 prot, datë 05.07.2017 " Mendim për Draft – Raportin e Vlerësimit të Jashtëm të akreditimit periodik të programit të studimit të ciklit të parë "Bachelor në Psikologji", ku njofton se Institucioni nuk ka komente dhe është dakort me vlerësimin e ekspertës.

GRUPI I VLERËSIMIT TË JASHTËM (GVJ)

1. Dr. Anila Sulstarova

Gjatë gjithë procedurës, ekspertja e jashtme e vlerësimit është asistuar nga specialisti i ASCAL Znj Majlinda Demirneli.

ANALIZË PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE TË DHËNA NGA KA NË VENDIMIN PËR AKREDITIMIN E PARË

Rekomandimet e dhëna në VKA Nr. 150, datë 18.02.2011 nga Këshilli i Akreditimit

- a) Të vlerësohet mundësia e rritjes së kontakteve edhe me universitete të tjera, vendëse dhe të huaja, publike dhe private, në mënyrë të veçantë europiane dhe amerikane që ofrojnë sidomos studime në psikologji për të qenë në korrent të ndryshimeve që pëson kurrikula e kursit në përshtatje me kërkesat e tregut të punës (mundësisht të ketë një marrëveshje bashkëpunimi me fokus programet e studimeve në psikologji me Universitetin e Tiranës).
- b) Të rishikohen kriteret e punësimit të pedagogëve të rinj me synim nxitjen dhe mbajtjen e tyre në punë për afate të gjate kohore. Nxitja dhe inkurajimi për pjesëmarrje dhe specializime brenda dhe jashtë vendit si dhe nëpërmjet një angazhimi me të plotë në punët e universitetit.
- c) Të shihet mundësia e vendosjes së kriterëve seleksionuese në pranimin e studentëve në programet e studimit Bachelor. Kjo do të ndikonte në rritjen e cilësisë.
- d) Të shihet mundësia e pasurimit të fondit të bibliotekës me botime në gjuhën shqip dhe në gjuhë të huaja sipas fushave të studimit.
- e) Të shihet mundësia e organizimit të një jete më aktive dhe të gjallë të studentëve pas mësimit.
- f) Është imediate zgjidhja e çështjes së kampusit të universitetit që do t'i jepte një vlerë më të madhe këtij institucioni.
- g) Duhet të shihet mundësia e ngritjes së një klinike për punën me studentët.

I. Plotësimi i tyre nga Institucioni

- a. Për rekomandimin: *"Të vlerësohet mundësia e rritjes së kontakteve edhe me universitete të tjera, vendëse dhe të huaja, publike dhe private, në mënyrë të veçantë europiane dhe amerikane".* U vu re se institucioni ka bërë ndryshime të dukshme në këtë drejtim. Kolegji Universitar "Wisdom



University”ka vendosur kontakte, marrëveshjeve dhe memorandumume të bashkëpunimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar me institucione arsimore dhe/apo kërkimore shkencore: Tempus, Jean Monnet, Erasmus+, binjakëzime dhe memorandumume mirëkuptimi në nivel institucional, me shkolla të larta universitare, akademi etj., Memorandumin e Mirëkuptimit me Institucionin e Arsimit të Lartë, MBS College of Greece, i cili është filial i Straffordshire University në Britaninë e Madhe. Një formë e binjakëzimit mes K.U. `Wisdom University` dhe Norman Academy, The Ruggero II University; Bashkëpunimi edhe me Universitetin e Padovas si dhe Universitetin e Teramos. Janë vendosur gjithashtu marrëveshje me Institucione të tjera të Arsimit të Lartë brenda vendit si: UET Universiteti European i Tiranës, SHLUJ. “Universiteti Marin Barleti”, Kolegji Universitar “Qiriazi”, Tirana Business University dhe Universitetin e Tiranës.

- b. Për rekomandimin: *“Të rishikohen kriteret e punësimit të pedagogëve të rinj me synim nxitjen dhe mbajtjen e tyre në punë për afate të gjate kohore. Nxitja dhe inkurajimi për pjesëmarrje dhe specializime brenda dhe jashtë vendit si dhe nëpërmjet një angazhimi më të plotë në punët e universitetit”*. U konstatua se institucioni e ka plotësuar deri diku këtë rekomandim, pasi nevoja për pedagogë në departamentin e psikologjisë është ende aktuale. Numri i stafit akademik të punësuar me kontratë pa afat ishte 7 dhe 7 profesionistë të tjetërë japin mësim në këtë department, që janë pjesë e njësive të tjera të kësaj IAL-je.
- c. Për rekomandimin *“Të shihet mundësia e vendosjes së kriterëve seleksionuese në pranimin e studentëve në programet e studimit Bachelor. Kjo do të ndikonte në rritjen e cilësisë”*, Për këtë rekomandim, institucioni bazohet në Legjislacionin mbi Arsimin e Lartë në RSH. Për vitin akademik 2016-2017 me Vendim Senati Nr. 16, datë. 15.02.2016 me nr. 137 Prot. ishin miratuar disa kriteret shtesë. Megjithatë, paqartësia për regjistrimet për vitin akademik 2016-2017 u ndjenë dukshëm në këtë institucion. Ky institucion ka përcaktuar disa kriteret që mund të ndiqen nëse sistemi i regjistrimit është më i qartë.
- d. Për rekomandimin *“Të shihet mundësia e pasurimit të fondit të bibliotekës me botime në gjuhën shqip dhe në gjuhë të huaja sipas fushave të studimit”* Institucioni është përpjekur të plotësojë këtë kërkesë, dhe literatura shqip ishte shtuar ndjeshëm, por mbetet ende çështje literature në gjuhë të huaj që ishte e vogël krahasuar me botimet e 5 viteve të fundit.
- e. Për rekomandimin *“Të shihet mundësia e organizimit të një jete më aktive dhe të gjallë të studentëve pas mësimit”*. U vu re se institucioni ka organizuar vizita në kompani të ndryshme, seminare dhe tryeza të rrumbullakta të përbashkëta. Përfshirja e studentëve në iniciativa bamirësie, studentët kanë krijuar organet e tyre si dhe klubet studentore të cilat i përfshijnë ata në aktivitete të ndryshme.
- f. Për rekomandimin *“Është imediate zgjidhja e çështjes së kampusit të universitetit që do t'i jepte një vlerë më të madhe këtij institucioni”*.

Institucioni ka zgjeruar hapësirat e nevojshme për salla leksionesh, laboratore, zyra, hapësira parkimi, mjedise çlodhëse, hapësira të gjelbra, hapësira të lira qarkullimi etj. Institucioni është e vendosur në tre godina. Sipas, RVB dhe vizitës në institucion ka një godinë pesë katëshe në Rrugën “Medar Shtylla” me një sipërfaqe totale 2262 m², nga të cilat 1262 m² janë sipërfaqe ndërtimi dhe 1000 m² oborr dhe ambiente të gjelbëruara. Ambientet plotësojnë kushtet higjeno-sanitare të nevojshme për të siguruar mbrojtjen efektive të shëndetit të studentëve dhe personelit.

- g. Për rekomandimin “Duhet të shihet mundësia e ngritjes së një klinike për punën me studentët”. Ky rekomandim është plotësuar vetëm për studentët e juridikut, por jo për ata të psikologjisë.

ADMINISTRIMI I NJËSISË NË SHËRBIM PROGRAMIT TË STUDIMIT

1. Misioni/Objektivat e programit të studimit

Pjesa përshkrimore


Terma reference: Qëllimet dhe objektivat e mësimdhënies dhe kërkimit shkencor, strategjitë afatshkurtra, afatmesme dhe afatgjata, ndjekja dhe përshtatja e objektivave dhe e qëllimeve me kohën, të dhëna të përgjithshme për IAL.

Sipas dokumentave të parë në Institucion dhe RVB:

Programi “Bachelor në Psikologji” përgatit specialistë me koncepte psikologjike dhe aftësi e shprehur metodologjike për studim kërkimor shkencor, duke i aftësuar në zbatimin praktik të njohurive në fushën e psikologjisë. Programi jep parimet bazë të shkencës së Psikologjisë, teoritë bashkohore psikologjike si dhe terapitë kryesore aplikative efektive të unifikuara në funksion të rritjes së cilësisë së shërbimit psikologjik.

Programi “Bachelor në Psikologji” ofrohet me 180 kredite (ECTS) dhe ka kohëzgjatje normale 3 vite akademike. Programi Bachelor në Psikologji bazohet në rregulloren e brendshme të departamentit dhe strukturën mësimore. Ky program ka për qëllim aftësimin e studentëve në praktikën e pavarur si psikologë të përgjithshëm, të trajtojnë fëmijët nxënësit dhe adoleshentët në: burgje, gjykata, në trajtimin e personave me nevoja të veçanta, me problematika specifike në kontekstin shkollor dhe në institucione të tjera private dhe publike, qendrat komunitare, institucionet politikbërëse, ojf, etj. Objektivat dhe strategjitë afatmesme dhe afatgjata janë në koherence me qëllimet e programit dhe të institucionit.

Vlerësimi sipas Standardeve



Standardet/kriteret	Vlerësimi sipas standardeve ¹
I - OFRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 3 Programet e studimeve hartohen në përputhje me qëllimet dhe misionin e institucionit;</p> <p>Kriteri 4 Programet e studimeve kanë objektiva të përcaktuar qartë për formimin e studentëve në atë program, të cilët përfshijnë dijet, aftësitë dhe kompetencat profesionale që duhet të fitojnë studentët në përfundim të programit të studimit dhe që karakterizojnë profilin e programit;</p> <p>Kriteri 5 Programet e studimeve hartohen në përputhje me nevojat e tregut të punës;</p> <p>Kriteri 6 Programet e studimeve hartohen në përputhje me zhvillimin ekonomik të vendit.</p>	<p>Programi është në përputhje me misionin dhe qëllimet dhe misionin e institucionit.</p> <p>Programi i studimit të Bsc nëPsikologji është ndërtuar bazuar në shprehitë teorike dhe praktike që është e nevojshme të merret në këtë fushë.</p> <p>Është ndërtuar si program bazuar në nevojat e tregut ndonëse mbulon vetëm formimin bazik të studentëve, formimi është i plotë.</p> <p>Nevojat e tregut te punës dhe zhvillimi ekonomik i vendit është konsideruar shumë në hartimin e këtij programi.</p>
Standardi I.2 - Programet e studimeve janë në përputhje me strategjinë për zhvillim të institucionit.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve janë përshtatur me strategjinë për zhvillim të institucionit;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë pajisjen me njohuritë bazë, mbi metoda e parime shkencore të përgjithshme;</p> <p>Kriteri 3 Programet e studimeve të ciklit të parë synojnë dhe formimin e shprehive të veçanta në një llojshmëri të gjerë profesionesh e specialitetesh.në realizimin e misionit dhe qëllimit të institucionit;</p>	<p>Programi synon zhvillimin në thellësi të programeve të kualifikimit profesional, duke u përputhur me strategjinë e zhvillimit të institucionit. Programet ofrojnë pajisjen me njohuri bazë, metoda dhe parime shkencore</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.1 - Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës.	
<p>Kriteri 1 Programet e studimeve synojnë të plotësojnë nevojat e tregut të punës, në përputhje me synimet strategjike të zhvillimit ekonomik kombëtar;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni, për vlerësimin e nevojave të tregut të punës, kryen një</p>	<p>Kriteret plotësohen duke bërë marrëveshje bashkëpunimi dhe vlerësimi të tregut të punës me institucione kombëtare dhe rajonale. Departamenti ka kryer një studim tregu, me temë "Shtrirje e shërbimit psikologjik në</p>

¹ GVJ duhet të shprehen me shkrim për të gjitha standardet (bazuar në kriteret përkatëse). Në fund të çdo rubrike grupi duhet të japë mendimin e tij për përmbushjen e standardit në tërësi.

<p>studim tregu, i cili përfshin:</p> <ol style="list-style-type: none"> mundësitë e punësimit të studentëve në tregun vendas ose atë rajonal, kombëtar e ndërkombëtar; kërkesat e punëdhënësve; një parashikim të përafërt për numrin e pritshëm të studentëve që mund të regjistrohen në këtë program; numrin e të regjistruarve në programe të ngjashme në institucionet simotra. 	<p>Shqipëri". me qëllim angazhimin e studentëve në tregun vendas të punës, rajonal dhe ndërkombëtar, me qëllim për të kuptuar kërkesat për specializantë në fushën e psikologjisë.</p>
<p>Standardi II.2 - Programet e studimeve synojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare dhe interesave kombëtare.</p>	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe studimesh që nuk bien ndesh me interesat kombëtare;</p> <p>Kriteri 2 Programet e studimeve synojnë të ndihmojnë ruajtjen e vlerave kulturore kombëtare.</p>	<p>Programet e studimit të ofruara nga Kolegji Universitar "WISDOM" dhe politikat e ndjekura janë hartuar në përputhje me politikat kombëtare mbi arsimin e lartë të MAS.</p> <p>Programet janë në harmonizim të plotë me vlerat kulturore e kombëtare</p>
<p>Konkluzione të GVJ: Grupi i vlerësimit të jashtëm konstaton se programi i studimit trevjeçar Bachelor në Psikologji në K.U. "WISDOM". është bazuar në legjislacionin në fuqi dhe është në përputhje me misionin, objektivat dhe strategjinë e zhvillimit të programit intitucionit. Po ashtu programi është hartuar në përgjigje të vlerësimeve të ndërmarra nga institucioni në lidhje me kërkesën e komunitetit të interesuar, si dhe gjykimeve të ekspertëve në fushë.</p> <p><i>Ky vlerësim paraprak, gjithsesi nuk përfaqëson një vlerësim të mirëfilltë të kërkesave të tregut të punës.</i></p>	

2. Struktura akademike e Fakultetit (përgjegjës për programin e studimit)

Pjesa përshkimore

Terma reference: përbërësit e njësisë dhe stafet e tyre, kompetencat, Baza e të dhënave të njësisë, freskimi i vazhdueshëm i saj dhe përgjegjësitë e mbajtjes dhe dhënies së informacionit

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Fakulteti, Organizimi hierarkik i Fakultetit
 - Këshilli i Fakultetit
 - Dekani
 - Departamenti i Ekonomisë
 - Departamenti i Psikologjisë
 - Njësia Shkencore dhe e Marrëdhënieve me Jashtë
- Organet e zgjedhura në të gjitha nivelet
 - Kolegji .Universitar "Wisdom University" përbëhet nga:

1. Fakulteti i Drejtësisë

1.1 Departamenti i të Drejtës Publike

1.2 Departamenti i të Drejtës Private

1.3 Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve me Jashtë.

2. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore:

2.1 Departamenti i Psikologjisë

2.2 Departamenti i Ekonomisë

2.3 Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënieve

- Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion
Nuk u morr asnjë dokument për këtë sesion.

Nga vizita në institucion nuk kishte ndryshime nga të dhënat që ishin paraqitur në RVB. Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore përbëhet nga :

1. Departamenti i Ekonomisë

2. Departamenti i Psikologjisë,

3. Njësia e Kërkimit Shkencor dhe e Marrëdhënieve me jashtë.

Departamenti i Psikologjisë ka gjithsej 8 pedagogë, nga të cilët 7(shtatë) janë personel akademik efektiv (PAE) dhe 1(një) personel akademik me kontratë. Njësia e Kërkimit Shkencor ka gjithsej 7 kërkues shkencorë/ pedagogë të cilët janë personel akademik efektiv (PAE). Pra në total mësimdhënësit për studentët e programit të psikologjisë janë **15 staf akademik gjithsej**. Fakulteti drejtohet nga Dekani i cili emërohet nga Rektori.

Këshilli i Fakultetit

Dekani

Departamenti i Ekonomisë

Departamenti i Psikologjisë

Njësia Shkencore dhe e Marrëdhënieve me Jashtë

3. Personeli akademik dhe personeli mbështetës për programin e studimit Pjesa përshkrimore

Terma reference: Të dhëna për kualifikimin e Personelit akademik, ndarja e tij në Personel Akademik Efektiv (PAE) dhe Personel Akademik me Kontratë (PAK), Personel Administrativ (PA), raporti PAE/PAK, raportet: Personel akademik/Personel administrativ/student; nevojat për Personel akademik/administrativ, shpërndarja e ngarkesës për personelin akademik, marrëdhëniet me strukturat e tjera jashtë kohës së punësimit, kriteret e rekrutimit të personelit akademik, etj.

Fakulteti drejtohet nga Dekani i cili emërohet nga Rektori. Personeli akademik dhe drejtuesit e institucionit kryejnë veprimtarinë e tyre në përputhje me statutin e K.U. "WISDOM". dhe përcaktimeve të parashikuara në kontratën e tyre me Institucionin. Nëpërmjet një personeli të kualifikuar mësimdhënës, drejtues, administrativ e mbështetës synohet garantimi i një shërbimi cilësor bashkëkohor

ndaj studentëve. Rekrutimi i personelit akademik mbështet mbi eksperiencën në mësimdhënien universitare, grada/titulli shkencor dhe aktiviteti kërkimor shkencor e botues. Personeli akademik dhe drejtuesit akademikë kryejnë veprimtari të mësimdhënies, të kërkimit shkencor Personeli akademik ndahet në personel të punësuar me kohë të plotë dhe me kohë të pjesshme. Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë është me kontratë me afat ose pa afat, dhe përbëhet nga drejtuesit, personeli akademik i brendshëm dhe i jashtëm.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Struktura didaktike (seksionet) për departamentetose programin e studimit

Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore përbëhet nga;
Departamenti i Ekonomisë
Departamenti i Psikologjisë
Njësia e Kërkimit Shkencor dhe e Marrëdhënieve me Jashtë.

Departamenti i Psikologjisë ka gjithsej 8 pedagogë, nga të cilët 7(shtatë) janë personel akademik efektiv (PAE) dhe 1(një) personel akademik me kontratë(PAK). Njësia e Kërkimit Shkencor ka gjithsej 7(shtatë) kërkues shkencorë/ pedagogë të cilët janë personel akademik efektiv (PAE). Stafi që anagazhohet në mësimdhënie për këtë program studimi në total është 15(pesëmbëdhjetë).

Numri i Personelit Akademik Efektiv (PAE) dhe Personelit Akademik me Kontratë (PAK), titujt/gradat, (Plotëso Tabelat Aneksi 1/2, të cilat mund të plotësohen edhe nga verifikimi i tabelave të paqyruara në RVB).

Për programin e studimit bachelor në psikologji janë përfshirë gjithsej 15(pesëmbëdhjetë) pedagogë nga të cilët 14(katërmëdhjetë) janë Personel Akademik Efektiv (PAE), dhe 1(një) është Personel Akademik me Kontratë. Nga 15 pedagogët e këtij programi studimi 10 janë me tituj dhe grada shkencore dhe 5 me master shkencor.

Të dhënat sipas kualifikimit dhe Raportet midis tyre (Plotëso Tabelën, Aneksi3)

Nuk ka asnjë pedagog me titullon Prof.Dr., është vetëm 1(një)Personel Akademik me Kontratë(PAK) me titull Prof.Assoc.Departamenti i psikologjisë ka 7(shtatë) Personel Akademik Efektiv (PAE) ndër të cilët 5(pesë) me grada dhe tituj. Njësia e kërkimit shkencor ka 7(shtatë) Personel Akademik Efektiv (PAE) ndër të cilët 4(katër) me grada dhe tituj shkencorë.

Raporti PAE/PAK me titullin doktor shkencash është 9/1. Ndërsa me titullin Master shkencor 5.

Të dhënat sipas seksit

Në departamentin e psikologjisë janë 7(shtatë) PAE, nga ku 5(pesë) janë të gjinisë femërore dhe 2(dy) janë të gjinisë mashkullore. Ndërsa në Njësinë e Kërkimit

shkencor të 7(shtatë) anëtarët janë të gjinisë femërore. Pra në total janë 12(dymbëdhjetë) pedagoge dhe 2 (dy) pedagogë.

☑ Të dhëna sipas moshës së personelit

Personeli akademik efektiv PAE përbëhet nga disa grup moshë,3(tre) janë në grup moshën 25-35 vjeç; 5(pesë) PAE dhe PAK janë në grup moshën 35-45 vjeç; 2(dy) PAE janë në grup moshën 45-55 vjeç; 4(katër) PAE janë në grup moshën 55-65 vjeç; dhe 1(një) PAE midis 65-68 vjeç.

☑ Kontratat e punës, njohja me detyrat dhe të drejtat

Personeli PAK dhe PAE ne departamentin e psikologjisë është me kontrata që njiheshin nga stafi. Në kontrata ishte e qartë puna e tyre, detyrimet dhe të drejtat.

☑ Cilësia e stafit ndihmës/ administrativ për çdo njësi bazë

Sipas GVJ cilësia e stafit administrativ të departamentit; Njesisë për kërkimin shkencor, bibliotekës, zyrës së karrierës ishte në përputhje me misionin e institucionit dhe me standartet e tij. Nga GVJ u panë kontratat e punës dhe u vu re qartësia e tyre dhe ishin firmosur nga të gjithë individët përkatës.

Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përben 100% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programit të studimit te ciklit të parë "Bachelor në Psikologji"

☑ Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion- NUK ka

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
III - PERSONELI I INSTITUCIONIT Standardi III.1 - Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit dhe vlerësimit të personelit.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të rekrutimit të personelit në përputhje me statutin dhe rregulloren;</p> <p>Kriteri 2 Personeli akademik i punësuar me kohë të plotë përbën së paku 70% të personelit akademik të angazhuar për realizimin e programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni ndjek procedura ligjore dhe transparente të vlerësimit të personelit;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni mban një bazë të dhënash të raporteve të rekrutimit të personelit, të njoftimeve për punë, etj.</p>	<p>Institucioni. i katë përcaktuara në dokumentacionin bazë kriteret dhe procedurat për punësimin e personelit akademik efektiv dhe personelin me kohë të pjesshme, si dhe në mbështetje tëbazës ligjore për rekrutimin e personelit nga Ligji për Arsimin e Lartë, Kodi i Punës, aktet nënligjore të MAS.</p> <p>Personeli Akademik me Kohë të plotë përbën 14/15 të personelit akademik të angazhuar në këtë program studimi.</p> <p>Personeli akademik me kohë të plotë përmbush 100% të planit mësimor. Vetëm një pedagoge e jshtme ka 2 lëndë në programin e psikologjisë.</p> <p>Pedagogët vlerësoheshn për punën e tyre 2 herë në vit nga studentët. Ata vlerësosheshin edhe nga përgjegjësi i departamentit dhe njësia për</p>

	<p>sigurimin e cilësië.</p> <p>Në zyrën e Burimeve Njerëzore e karrieres dhe jetës studentore u gjenden dosjet e aplikantëve të cilët aplikojnë në fillim të vitit akademik.</p>
Standardi III.2 - Institucioni disponon një bazë të dhënash për personelin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni disponon një bazë të dhënash të hollësishme për anëtarët e personelit akademik të përfshirë në program dhe të personit përgjegjës për organizimin e programit të studimit;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni disponon listën e plotë të personelit akademik për secilin semestër, të personelit ndihmës mësimor-shkencor dhe atij administrativ;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon kriteret dhe procedurat e rekrutimit të personelit akademik;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni angazhon si titullarë të lëndëve/moduleve për programet e studimeve të ciklit të parë, personel akademik që ka së paku gradën shkencore “Doktor, ose titullin akademik “Docent,.”</p>	<p>KU “WISDOM” ka të dhëna për personelin akademik të përfshirë në program, të sistemuara në dosjen personale të çdo pedagogu, si dhe për personin përgjegjës për PS</p> <p>Zyra e Burimeve Njerëzore, e Karrieres dhe Jetes Studentore në nivel institucional, ka një bazë të dhënash për të gjithë personelin akademik të përfshirë në programin e studimit “Bachelor në Psikologji”, personelin administrativ dhe studentët dhe stafin administrativ.</p> <p>Institucioni ka përcaktuar kriteret dhe procedurat të qarta për rekrutimin e stafit, IAL i publikon ato rregullisht në website, kur lind nevoja për rekrutime të reja</p> <p>Në Programin “Bachelor në Psikologji”, Institucioni ka angazhuar si titullarë të lëndëve/moduleve personel me grada dhe tituj shkencorë si edhe pedagogë të specializuar në universitete perëndimore, dhe pedagogë të cilët janë në proces të studimeve të doktoraturës.</p> <p>Leksionet mbuloohen në masën 80% nga PAE me gradën doktor shkencash. Pjesa tjetër e stafit PAE janë në proces doktrature.</p>
Standardi III.3 - Institucioni angazhon personel ndihmës mësimor shkencor dhe administrativ për përmbushjen e misionit të tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të personelit ndihmës mësimor-shkencor për realizimin e orëve laboratorike dhe për mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni dëshmon një angazhim optimal të burimeve njerëzore për përmbushjen e objektivave të programeve të studimeve të ciklit të parë;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni vë në dispozicion personel të mjaftueshëm për instruktimin, udhëheqjen dhe mbikëqyrjen e studentëve në praktikën profesionale (së paku 1 tutor/instruktor për 12 studentë).</p>	<p>Kurrikula e PS nuk përmban orë laborator, megjithatë KU “WISDOM” ka personel të mjaftueshëm që mundëson mirëmbajtjen e laboratorëve e mjediseve shkollore.</p> <p>Stafi akademik dhe ai ndihmës ishin në funksion të arritjes së objektivave të programit të studimit “Bachelor në Psikologji”</p> <p>Në programin e studimit “Bachelor në Psikologji” caktohen 2 tutorë për mbikëqyrjen e praktikës profesionale.</p> <p>Numri i studentëve është 38 aktualisht në vit të parë dhe të dytë. <i>Nuk kanë studentë në vitin e tretë për të parë ngarkesën dhe mënyrën si përballohet</i></p>



Standardi III.4 - Institucioni angazhohet për kualifikimin e vazhdueshëm dhe të mëtejshëm të personelit të tij.

Kriteri 1 Institucioni organizon programe specifike për kualifikimin e mëtejshëm profesional të personelit akademik e të personelit mësimor-shkencor;

Kriteri 2 Institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara.

K.U. "WISDOM". ka përpjekje serioze për nxitje për rritje profesionale të personelit akademik dhe shkencor. Pjesëmarrja në konferenca shkencore dhe botime në revista shkencore ishte e pranishme.

Sipas vlerësimit të GVJ institucioni disponon një bazë të dhënash të programeve të studimeve të ofruara që janë edhe publike në revistat apo broshurat e prodhuara nga ky institucion.

Konkluzione të GVJ: Konstatohet se personeli akademik dhe administrativ i institucionit është i mirëinformuar në lidhje me rregullat e institucionit, objektivat dhe misionin. Dokumentacioni bazë i institucionit, aktet ligjore kryesore, rregulloret që rregullojnë veprimtarinë e institucionit janë të publikuara dhe janë të aksesueshme nga i gjithë personeli. Marrëdhëniet midis personelit dhe institucionit janë të rregulluara përmes kontratave të detajuara. Personeli akademik i angazhuar në këtë program përmbush kriteret e nevojshme në lidhje me gradat, titujt dhe eksperiencën. Informacioni në lidhje me personelin administrativ dhe akademik, si dhe në lidhje me programet mësimore është i ruajtur dhe i dokumentuar pranë zyrës së Burimeve Njerëzore, ose sipas rastit në Departament.

4. Infrastruktura në funksion të programeve të studimit, logjistika dhe shërbime të tjera ndaj komunitetit

Pjesa përshkrimore

Terma reference: mjediset, infrastruktura, teknologjitë e informacionit, biblioteka, shërbime të tjera për studentët, residencat.

Të dhënat e paraqitura në RVB u verifikuan edhe në vizitën në institucion dhe bazuar në dokumente dhe vëzhgime: K.U. "WISDOM". në total ka një sipërfaqe të konsiderueshme përdorimi të destinuar për salla leksionesh, laboratore, zyra, hapësira parkimi, mjedisë çlodhëse, hapësira të gjelbra, hapësira të lira qarkullimi. Materialet dhe teknologjia e punimeve sigurojnë akustikë të mirë në ambientet e mësimit dhe janë të izoluara ndaj zhurmave, luhatjeve të temperaturës dhe lagështirës (tavanet e ambjentëve janë të veshura me pllaka allçie me akustikë të lartë, të gjitha dritaret janë të përshtatshme dhe me dy shtresa fletë xhami.

Një godinë pesë katëshe në Rrugën "Medar Shtylla" me një sipërfaqe totale 2262 m², nga të cilat 1262 m² janë sipërfaqe ndërtimi dhe 1000 m² oborr dhe ambiente të gjelbëruara. Ambientet janë moderne e komode dhe plotësojnë kushtet higjeno-sanitare të nevojshme për të siguruar mbrojtjen efektive të shëndetit të studentëve dhe personelit. Një godinë 4 katëshe në Rrugën "Medar Shtylla" me një sipërfaqe totale 418 m², në të cilën janë vendosur sallat e pedagogëve të Fakultetit të Shencave Ekonomike dhe Shoqërore, Zyra e

Kurrikulave, NJSBC, Dekanati, Instituti per Kërkim dhe Zhvillim "Wisdom" Departamentet përkatëse dhe Njësia e Kërkimit Shkencor dhe Marrëdhënive me Jashtë.K.U. "WISDOM". disponon një godinë në Rugën e Dibrës me sipërfaqje totale 585 m² në të cilën është vendosur 1 sallë interneti dhe një sallë promovuese me sipërfaqje 45m². Mjediset janë në gjendje të thatë dhe pa lagështi.Godina 2 dhe 3 katëshe në adresën "Rr e Dibrës, Nr 155 dhe Nr 165 e rregjistruar në Rregjistrin Hipotekor. Kontrata është e noterizuar dhe ka Nr. Rep.1628 data e nënshkrimit të kontradës 02.09.2014. Në bibliotekë ka 12 laptop-e (dhe 8 të tillë në auditorë) për përgatitjen e detyrave të kursit, seminareve, kumtesave shkencore, punimeve kërkimore shkencore. Biblioteka është pasuruar me tituj të rinj nga shtatori 2015 por ende mbetet jo e pasur me libra në fushën e psikologjisë. Materialet bibliotekare janë regjistruar dhe përpunuar sipas kërkesave ligjore, IFLA (World Information and Information Congres) dhe Ligjit nr. 8576, datë 03.02.2006. "Për bibliotekat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar. Studentët dhe stafi akademik kanë akses në shfrytëzimin online të faqes elektronike. <https://Wisdom.ebookcentral.proquest.com/libcentral>, të instaluar në laptopët e sallës së leximit në bibliotekë. Është siguruar një ambient i bibliotekës me 30 vende studimi, për studentët dhe stafin. U është bërë me dije studentëve për librat që ata mund të studiojnë, huazojnë apo blejnë në bibliotekë. Është siguruar shërbim interneti falas për studentët dhe stafin e institucionit. Biblioteka është pasuruar edhe me revista psikologjike, juridike, shkencore jo vetëm në fushat përkatëse të studimit. Revista shkencore "Wisdom" u hartua në vitin 2015 e cila është konceptuar për të shërbyer në funksion të formimit shkencor e profesional të stafit akademik, studentëve, por edhe të punonjësve të praktikës. (marrë nga RVB)

Ambientet janë komode dhe plotësojnë kushtet higjeno-sanitare të nevojshme për të siguruar mbrojtjen efektive të shëndetit të studentëve dhe personelit. Materialet dhe teknologjia e punimeve sigurojnë akustikë të mirë në ambientet e mësimit dhe janë të izoluar ndaj zhurmave, luhatjeve të temperaturës dhe lagështirës.

Ndryshimet dhe luhatjet normale të temperaturave. Funkcionim dhe rregullim automatik digital të sistemit ngrohje-ftohje. Temperatura e ajrit në mjediset e K.U. "WISDOM"., sallat e pedagogëve, auditorët, koridoret, nyjet hidrosanitare, shkallët, etj. janë në përputhje të plotë me kriteret e përcaktuara në pikën 6 të VKM Nr.38, datë 16.01.2003 "Për miratimin e normativave, të rregullave e kushteve të projektimit të ndërtimit, të prodhimit dhe ruajtjes së nxehtësisë në ndërtesa".

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Mjediset për Programin e studimit

- Salla për leksione dhe seminare 6 salla me sipërfaqje 328 m²
- Salla për aktivitete promovuese 2 salla me sipërfaqje 151 m²
- Salla për praktikë lëndore/ profesionale- *Nuk ka klinikë psikologjike për praktikat profesionale apo shërbime ndaj studentëve.*

- Laboratorë për lëndët- Nuk ka lëndë për të cilët mund të duhet një laborator i tillë
- Laboratorë informatike- ka 1 laborator informatike 30m²
- Salla interneti- ka 1 sallë interneti me sipërfaqje 28m²
- Salla për bibliotekë- salla e bibliotekës (1 sallë) është 54 m²
- Mjedis për fotokopjime, librari etj- janë 4 mjedisë që ofrojnë këtë shërbim 20m² secila
- Zyrë informacioni për studentët- në këtë institucion ka 1sallë të tillë 10m²
- Nyje hidrosanitare- janë 4 nyje hidrosanitare 16m²

Mjediset për stafin:


- Mjedise për Dekanin/ kancelarin- 1zyrë 16 m²
- Zyra për sekretarinë mësimore- 1 zyrë 27m²
- Zyra për departamentet/qëndrat kërkimore- 4 zyra 60 m²
- Zyra për personelin akademik- 4 zyra 126 m²

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Gjatë vizitës në institucion u morr lista me librat që ekzistojnë në biblioteke dhe u bë verifikimi i tyre.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
V - INSTITUCIONI OFRON SHËRBIME DHE VË NË DISPOZICION TË STUDENTËVE BIBLIOTEKA DHE BURIME TË TJERA INFORMACIONI	
Standardi V. 1- Institucioni vë në dispozicion të studentëve bibliotekën e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni vë në dispozicion të studentëve tekste mësimore dhe literaturë ndihmëse të mjaftueshme në sasi dhe cilësore;</p> <p>Kriteri 2 Në bibliotekë ka literaturë të mjaftueshme që e ndihmon studentin për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 3 Në bibliotekë ka botime periodike dhe programe kompjuterike, si libraritë elektronike, të cilat përmbajnë libra apo revista shkencore të nevojshme për realizimin me sukses të programit të studimit;</p> <p>Kriteri 4 Përgjegjësit e programit hartojnë një plan të detajuar për shtimin e zërave të bibliotekës në mbështetje të programit, përfshirë edhe buxhetin e planifikuar për të;</p> <p>Kriteri 5 Biblioteka shpall oraret e</p>	<p>Nga vëshgimet në sylabuset e lëndëve dhe librave që ishin në bibliotekë të gjitha lëndët kishin litareturën përkatëse.</p> <p>Studentët dhe stafi akademik kanë akses në shfrytëzimin online të faqes elektronike "ProQuest" në laptopët e sallës së leximit në bibliotekë. <i>Ndonëse librat në gjuhë të huaja në fushën e psikologjisë ishin jo të shumtë në numër.</i></p> <p>Nuk kishte abonim në revistat shkencore me faktorë impakti të lartë të universiteteve jashtë vendit.</p> <p>Titujt e librave të rinj në shqip janë shumë më të shtuara, <i>por mbetet ende punë për titujt në të gjitha fushat e psikologjisë.</i></p> <p>Institucioni ishte duke reflektuar për rritjen e numrit të librave akademikë dhe revistave</p>



shërbimit në përshtatje me oraret e programit të studimit dhe nevojat e studentëve.	shkencore. Biblioteka funksionon me orare të qarte për të gjithë studentët dhe stafin, nga e Hëne-Premte 09:00-19:00
Standardi V. 2- Institucioni vë në dispozicion të studentëve laboratorë dhe mjedise të përshtatshme mësimore dhe për formimin praktik.	
<p>Kriteri 1 Institucioni dëshmon se ka në sasi të mjaftueshme: laboratorë, klasa, zyra, studio e mjedise të tjera me pajisje elektronike dhe të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit tëstudimeve;</p> <p>Kriteri 2 Pajisjet e mjedisëve mësimore janë të përshtatshme për mësimdhënie në përputhje me qëllimet e programit;</p> <p>Kriteri 3 Laboratorët përmbajnë aparaturat dhe mjetet e nevojshme për plotësimin e kërkesave të programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve që ofron, ka së paku një laborator.</p> <p>Kriteri 5 Institucioni, në varësi të programeve të studimeve, disponon kompjutera në laboratorët e teknologjisë së informacionit, të pajisur me programe profesionale si programe për statistikë, linguistikë, arkitekturë, inxhienieri, ekonomi, mjekësi, programestimulimi për shkencat sociale etj.</p> <p>Kriteri 6 Institucioni garanton, me kapacitetet që zotëron ose në bashkëpunim me institucione dhe subjekte të tjera, që mjediset janë të mjaftueshme për zhvillimin e praktikave profesionale.</p>	<p>Sipas të dhënave të detajuara të RVB-së dhe vizitës në IAL konstatuam që ky Institucion ka hapësira të mjaftueshme për zhvillimin e PS</p> <p>Institucioni ka klasa për leksione dhe seminare të përshtatshme dhe në raport të mirë me numrin e studnetëve. Pajisjet teknologjike janë në funksion të studentëve me programet e nevojshme. dhe plotësojnë çdo nevojë. Ka një sallëvideo konference.</p> <p><i>Mungon klinika në të cilën të zhvillohet praktika klinike me studentët, por edhe për ta kthyer atë në zyrë që ofron shërbime për komunitetin.</i></p> <p>Në këtë isntitucion ka 1(një) sallë interneti të pajisur me kompjutera, laboratorë, klasa, zyra, e mjedise të tjera me pajisje të teknologjisë së informacionit, për realizimin e programit të studimit</p>
<p>Konkluzione të GVJ: Institucioni ka infrasturkurën fizike dhe teknologjike të përshtatshme me kërkesat bashkëkohore. <i>Biblioteka është e pasur në tituj librash nga autorë shqiptare dhe përkthime, por mungojnë shumë tituj kryesorë të fushave të psikologjisë. Gjithashtu edhe regjistrimi në revista shkencore online. Mungon edhe klinika e shërbimeve psikologjike për të ofroar si ndihmën ndaj studnetëve ashtu edhe për praktikën klinike të nevojshme si edhe për ta përdorur si burim ndihme për komunitetin. Pasja e kësaj klinike do të ishte shumë e nevosjhme për pedagogët që të zhvillonin shprehitë aplikative, studentët që të shohnin raste konkrete dhe komunitetin që do të kish një burim ndihme. Gjithsesi, këto orë pune praktike kompensohen përmes praktikave profesionale pranë institucioneve të përshtatshme, si dhe përmes punës në auditore të monitoruar nga pedagogu i lëndës përkatëse.</i></p>	

5. Financimi dhe menaxhimi i burimeve financiare

Pjesa përshkimore

Terma reference: burimet e financimit, kostoja për student, kapacitetet menaxhuese.

Kolegji Universitar Wisdom mbështetet kryesisht në të ardhurat e krijuara nga pagesat e studentëve. Veprimtaria e tij ekonomike, siç u informuam gjatë vizitës në institucion reflektohet në bilancet financiare të cilat përgatiten dhe depozitohen sipas kërkesave ligjore tatimore. Institucioni realizon periodikisht auditim të brendshëm të fondeve dhe shpenzimeve të kryera, të cilat mundësojnë analizimin e plotë të situates ekonomiko-financiare dhe shpërndarjen/alokimin e fondeve në mënyrë efçente. Lidhur me Koston për Student, Kolegji është në process vlerësimi/analizimi të vazhdueshëm, megjithatë sic rezulton edhe nga Tabela e Bilancit midis të ardhurave dhe shpenzimeve në vitin 2014 dhe vitin 2016 shpenzimet kanë rezultuar më të mëdha në raport me të ardhurat, duke u fokusuar në shpenzime për përmirësimin e infrastructures së Kolegjit. Lidhur me vitin 2016, mund të thuhet se është i vetmi vit që institucioni ka realizuar fitim. Në këtë këndvështrim, konkludohet se mesatarisht, kosto për student i kalon pagesën/tarifën që student paguan për shkollimin e tij.

Lidhur me kapacitetet menaxhuese, burimet njerëzore për këtë veprimtari janë bazuar të Kancelari i Kolegjit si dhe tek Zyra e Financës. Për një shpenzim sa më efficient të fondeve për programin BSc në Drejtësi, u informuam se ka komunikime, takime dhe diskutime të vazhdueshme midis Dekanit, Rektorit dhe Kancelarit për të koordinuar interesat/kërkesat e programit me mundësitë financiare. Më pas, ekzekutimi i kësaj vendimarrjeje realizohet nga Zyra e Financës, e cila proçedon me përgatitjen e të gjithë dokumentacionit financiar.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të ardhurat dhe financimet e ndryshme në këtë program studimi **(në përqindje):**

- Grantet për kërkim – nuk ka
- Konsulencat, shërbimet – nuk ka
- Tarifat për dhe gjatë shkollimit- 63.012,063 për vitin akademik 2016-2017, ose 100%
- Sponsorizime- nuk ka
- Shërbimet trainuese (kualifikimi i vazhdueshëm)- nuk ka
- Donacionet, aktivitetet siguroese, fondacione etj- nuk ka
- Aktivitetet tregtare (mensa, kafe, bare, residencat, etj)- nuk ka

Shpenzimet për studentët dhe kosto e studimit për student për vit akademik (në përqindje) nuk ka

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Nga GVJ nuk u morr asnjë dokumantacion sepse verifikimet për të ardhurat e studentëve u kryen në terren.

Vlerësimi sipas Standardeve



II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE

Standardi II.5 - Institucioni vlerëson dhe dokumenton gjendjen e tij financiare.

Kriteri 1 Institucioni bën një auditim të përvitshëm (të jashtëm ose të brendshëm) të situatës financiare të tij;

Kriteri 2 Në raportin e auditit paraqiten të gjitha detyrimet financiare, pagat e personelit, shpenzimet operative, etj;

Kriteri 3 Raporti i auditit përmban një pasqyrë të qartë të granteve të huaja të përfituara dhe kontratave të shërbimeve të lidhura në funksion të realizimit të programeve të studimeve të ciklit të parë.

Kolegji realizon auditim të përvitshëm të situatës së tij financiare, në varësi të të ardhurave që vijnë kryesisht nga tarifat e studimit. Ky është një detyrim financiar që kërkohet edhe nga legjislacioni tatimor në fuqi, ndaj auditimi i brendshëm dhe i jashtëm është një proces që realizohet cdo vit.

Raportet financiare përmbajnë të gjitha elementët/zërat financiarë lidhur me të ardhurat dhe me shpenzimet.

Raporti nuk përmban informacion financiar lidhur me Grantet apo të ardhura të tjera që mund të jenë përfituar nga kontratat e shërbimeve. Nga intervista në institucion rezulton se përfitime të tilla, nuk ka pasur.

VI - BURIMET FINANCIARE DHE VLERËSIMI FINANCIAR

Standardi VI.1 - Institucioni harton një raport financiar të kostove të programeve të studimeve.

Kriteri 1 Institucioni harton një raport financiar që përmban një pasqyrë të hollësishme financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare;

Kriteri 2 Institucioni dokumenton raportet financiare për tri vitet e kaluara akademike;

Kriteri 3 Institucioni dëshmon një qëndrueshmëri financiare përgjatë kohës së zhvillimit të programit të studimit dhe se ka kapacitete financiare të mjaftueshme për përmirësimin e situatës financiare dhe gjenerimin e të ardhurave të domosdoshme në të ardhmen.

Kolegji Universitar Wisdom harton raportin financiar që përmban një pasqyrë të detajuar financiare të të ardhurave nga tarifat e shkollimit dhe kontributeve të tjera financiare për studentët ose ndarjen e burimeve financiare; Këto informacione janë të reflektuara për të gjitha vitet e tjera. Lidhur me qëndrueshmërinë financiare të institucionit, vihet re që përgjatë viteve të zbatimit të programit BSc në Psikologji, por edhe gjatë periudhave të mëparshme, pagesat janë kryer në kohë, pa vonesa dhe përveç burimeve financiare nga tarifat e studentëve, Kolegji ka investuar në infrastrukturë, që lidhet edhe me kryerjen e shpenzimeve operationale. Zhvendosja dhe Investimi në një godinë të re, të mirë-organizuar dhe të përshtatur për nevojat e Kolegjit krijojnë gjithashtu premisa për një zhvillim të qëndrueshëm edhe financiar të institucionit.

Kjo vihet re edhe në faktin që gjatë viteve 2015-2017, shpenzimet i tejkalojnë ndjeshëm të ardhurat e programit, gjë që synohet të përmirësohet në vitet në vijim - kjo është edhe arsyeja pse institucioni po investon për të krijuar asete të qëndrueshme materiale dhe

	njerëzore, me qëllim që të krijojë terrenin e përshtatshëm për të përthithur më shumë studentë vitet e ardhshme në programin Bachelor në Psikologji, si dhe në programe të tjera.
<p>Konkluzione të GVJ: Kolegji Universitar Wisdom mbështetet kryesisht në të ardhurat e krijuara nga pagesat e studentëve. Veprimtaria e tij ekonomike reflektohet në bilancet financiare të hartuara kërkesave ligjore tatimore. Institucioni realizon periodikisht auditim të brendshëm të fondeve dhe shpenzimeve të kryera, të cilat mundësojnë analizimin e plotë të situatës ekonomiko-financiare dhe shpërndarjen/alokimin e fondeve në mënyrë efçente. Kosto për Student tejkalon tarifën e shkollimit pasi shpenzimet tejkalojnë të ardhurat. Institucioni/Kolegji ka burime njerëzore të përshtatshme dhe të mjaftueshme dhe ka një koordinim mjaft të mirë të punës për një shpenzim sa më efçient të fondeve për programin BSc në Psikologji. Institucioni ka reflektuar qëndrueshmërinë financiare, ka investuar në infrastrukturë dhe ka kryer investime për të krijuar asete të qëndrueshme materiale dhe njerëzore për të përthithur më shumë studentë vitet e ardhshme.</p>	

6. Sistemi i Brendshëm i Sigurimit të Cilësisë

Pjesa përshkrimore

Terma reference: institucionalizimi i sistemit të brendshëm të sigurimit të cilësisë, ngritja e Njësisë së SBC, funksionimi i saj, vetëvlerësimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm i cilësisë, rezultatet e vlerësimeve të jashtme.

Sigurimi i brendshëm të cilësisë në K.U. "WISDOM". kryhet përmes Njësisë së Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë. Zyra funksionon sipas Rregullores së NjsBC së K.U. "WISDOM". NjsBC, pas riorganizimit të saj, ka bërë Planin strategjik 5 vjeçar i zhvillimit të K.U. "WISDOM". për vitet 2012-2017 si dhe: miratimin me Vendim Nr.41/1 dt.24.10.2016, për Formularin Shkencor. NjsBC menaxhon proceset didaktike dhe ofron analiza, rekomandime. NjsBC vlerëson kapacitete njerëzore në fushën akademike e kërkimore, vlerësimin e programeve të reja mësimore. NjsBC gjithashtu monitoron, vlerëson dhe rishikon efikasitetin e programeve të lëndëve dhe në vazhdimësi. Kjo njësi bën 2 pyetësorë në vit nga studentët për lëndët për semestrin e parë dhe të dytë. Për të organizuar dhe siguruar efektivitetin e procesit mësimor (mësimdhënia / mësimnxënia), në përputhje me lirinë akademike është asistuar në disa seminare dhe leksione për lëndët përkatëse sipas një kalendari të paracaktuar nga vetë Në fund të çdo semestri, nga pedagogët e lëndës bëhen relacione për mbarëvajtjen dhe përmbushjen e programit mësimor të lëndëve, sipas kurrikulave dhe sylabuseve. Njësia operon në bazë të një databaze instrumentesh vlerësuese dhe dokumentacioni përkatës, të cilat u behën me dije personelit akademik përmes internetit. Vlerësimet e ndërmarra nga NjsBC konkludojnë në raporte të vlerësimit të performancës dhe proceseve akademike dhe u bëhen me dije në

mënyrë të personalizuar personelit të përfshirë në vlerësim. Procesi i vlerësimit në K.U. "WISDOM". është i integruar dhe përfshin studentët, personelin drejtues dhe indikatorët të tjerë të cilësisë

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna sasiore për punën konkrete në NJSBC për programin e studimit, si:

NJSBC përbëhet nga 7 (shtatë) anëtarë. Përbërja e njësisë është në përputhje me amendamentet e miratuara nga Senati (Aneksi 3, Tabela 4). NJSBC menaxhon proceset didaktike, duke aplikuar instrumente vlerësimi në fushën akademike e kërkimore analiza, rekomandime dhe informacione lidhur me veprimtaritë.

o Sa anketime kanë bërë me studentët:

Studentët përfshiheshin në 2 anketime në vit lidhur me cilësinë e mësidhënies dhe vlerësimin për infrastrukturën.

o Sa studentë janë anketuar

Në vitin e fundit akademik për vlerësim për departamentin e psikologjisë janë anketuar 41 studentë.

o Sa prej tyre janë përpunuar dhe çfarë problemesh kanë dalë:

Të gjitha pyetësorët janë përpunuar dhe realizimi i tyre u është përcjellë pedagogëve dhe përgjegjësve të departamentit, dekanit. Sipas pyetësorëve të fundit, problematika e fundit dhe e vetme lidhej me përdorimin e power point në leksione.

o Cilat kanë qenë hapat e mëtejshëm

Kërkesa e studentëve iu përcoll përgjegjësit të departamentit dhe pedagogut përkatës nga NJSBC. Përbërja e njësisë është në përputhje me amendamentet e miratuara nga Senati (Aneksi 3, Tabela 4). Pasi pedagogu u njoh me kërkesën e studentëve e filloi të përdorte power point-in. Edhe në takimin me studentët kjo gjë u tha edhe prej tyre dhe ishin marrë menjëherë masat.

Kontrolli i brendshëm i cilësisë

Kontrolli i brendshëm i cilësisë realizohet nga NJSBC. Në fillim të cdo viti akademik organizohen takime me stafin akademik për tu njohur me planet lidhur me përmirësimin e sylabuseve, nevojën për kërkimin shkencor, rritjen e cilësisë së mësidhënies. Kjo njësi përveç pyetësorëve të studentëve vlerëson dy herë në vit pedagogët duke ndjekur orë leksioni apo seminari. Në këto kontrole rutinë përfshihen edhe përgjegjësit e departamenteve. Hartohen raporte për çdo pedagog për arritjet e tij në mesimdhënie apo kërkim shkencor.

Përgjegjësitë në monitorimin dhe menaxhimin e cilësisë deri në nivel departamenti (Plotësoni Tabelën 4, Aneksi 4)

Përgjegjësitë për monitorim i ka zyra e NJSBC në bashkëpunim me përgjegjësit e departamenteve dhe Dekanin. Nuk është raportuar po nuk u vunë re probleme apo konflikte mes kësaj njësie dhe pedagogëve.

Vetëvlerësimet e kryera dhe rezultatet e tyre

Vetëvlerësimet realizohen dy herë në vit. Ato u raportuan edhe nga takimet me pedagogët dhe studentët që janë pozitive dhe me elementë shumë domethenës për tu përmirësuar sic është rasti i përdorimit të Power point-tit.

Politikat e përmirësimit të cilësisë mbi bazën e vetëvlerësimeve periodike

Nga takimet e GJV me aktorët kryesorë nuk u raportuan raste të mungesës së profesionalizmit nga ana e pedagogëve apo stafit mbështetës. Megjithatë, kërkesa për përmirësim të vazhdueshëm u raportua të jetë nevojë e pedagogëve që përpiqeshin të përmirësoheshin përmes pjesëmarrjes nëpër konferenca shkencore, kryerjes së studimeve dhe praktikave me studentët. Pjesëmarrja nëpër konferenca apo kongrese mbështetej nga institucioni në funksion të përmirësimit të cilësisë.

Dokumentacioni përkatës i marrë në vizitat në institucion

Nuk u mor dokumentacion për këtë rubrikë

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.3 - Institucioni, për akreditimin e programeve të studimeve, përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e tyre.	
<p>Kriteri 1 Institucioni përdor metodologji vlerësimi, instrumente matëse dhe vlerësuese për ecurinë e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Institucioni e përfshin këtë informacion në vetëvlerësimin institucional;</p> <p>Kriteri 3 Institucioni publikon rezultatet e pritshme, rezultatet e vlerësimit dhe rezultatet që synon të arrijë;</p> <p>Kriteri 4 Institucioni, për kryerjen e vlerësimit, përdor metoda të tërthorta ose të drejtpërdrejta:</p> <p>Të tërthorta:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Sondazhe: të studentëve që ndjekin programet e studimeve, të të diplomuarve; b. Sondazhe të vlerësimit të didaktikës, kurrikulës, të mësuarit; c. Pyetje konceptuale; d. Intervista; e. Etj. <p>Të drejtpërdrejta:</p> <ol style="list-style-type: none"> a. Teste të standardizuara kombëtare/ndërkombëtare (p.sh. provimi i shtetit për profesionet e rregulluara); b. Dëgjime në auditor; 	<p>KU " WISDOM" ka hartuar një metodologji për vlerësimin e brendshëm dhe ka përcaktuar instrumentat matëse dhe vlerësuese për programin e studimit.</p> <p>Është institucionalizuar praktika e sigurimit të brendshëm të cilësisëpërmes NJSBC.</p> <p>Përdoren metodologji të caktuara me instrumenta matës dhe vlerësues të tilla si: pyetësor nga/për studentët dhe pedagogët. Rezultatet publikohen duke ruajtur privatesinë e të dhënave.</p> <p>Në fund të çdo semestri akademik studentët japin mendimin e tyre në lidhje me lëndën, dhe opinione për lëndën e dhënë nga pedagogu përkatës. NJSBC realizon sondazhe dhe intervista të studentëve në lidhje me përmirësimin e kurrikulës.</p> <p>Metodat e tërthorta të vlerësimit janë pyetësorët e studentëve, të cilët</p>



- c. Vlerësimi me nota/pikë;
- d. Testime paraprake dhe përfundimtare; provime për module, praktikë;
- e. Vlerësimi i detyrave të kryera nga studentët (detyra kursi për të analizuar të kuptuarit konceptual, provimet, referatet);
- f. Vëzhgime gjatë kryerjes së ushtrimeve/praktikës;
- g. Etj.

vlerësojnë;komunikimin student-pedagog, infrastrukturën mësimore; mendime dhe sugjerime nga studentet

Metodat e drejtpërdrejta të vlerësimit janë:

- Vlerësim me pikë për aktivizimin në auditor;
- Vlerësime me notë dhe me pikë;
- Testime paraprake dhe përfundimtare
- Vlerësim të detyrave të kryera nga studentët;
- Vëzhgime gjatë kryerjes së praktikës nga tutori/pedagogu përgjegjës.

VIII - INSTITUCIONI GARANTON SIGURIMIN E CILËSISË

Standardi VIII.1 - Institucioni garanton sigurimin e cilësisë në realizimin e programeve të studimeve.

Kriteri 1 Institucioni ka plotësuar standardet institucionale dhe është akredituar në nivel institucional përpara aplikimit për akreditimin e programeve të studimeve;

Kriteri 2 Institucioni përdor instrumentet e duhura për sigurimin e cilësisë;

Kriteri 3 Institucioni harton një politikë të qartë dhe ndjek procedurën e vlerësimit periodik të efikasitetit të veprimtarive që kryen për sigurimin e cilësisë dhe standardeve të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 4 Institucioni përdor mekanizma formalë për shqyrtimin, miratimin dhe mbikëqyrjen e herëpashershme të programeve të studimeve që ofron;

Kriteri 5 Institucioni synon ndërgjegjësimin e personelit të vet dhe të studentëve që ndjekin programet e studimeve që ofrohen për rëndësinë e cilësisë dhe sigurimin e cilësisë në to;

Kriteri 6 Institucioni harton dhe zbaton një strategji për përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë. Strategjia, politika dhe procedurat janë publikuar.

K.U. "WISDOM". i ka plotësuar standardet e akreditimit në nivel institucional. K.U. "WISDOM". është akredituar me Urdhrin Nr. 237, datë 09.05.2016 të Ministrit të Arsimit dhe Sportit.

Është ngritur Njësia e Sigurimit të Brendshëm të Cilësisë dhe ka përgatitur instrumente, të cilat i përdor në funksion të sigurimit të cilësisë.

Përmes takimeve me stafin akademik të shpeshta dhe të protokolluara përditësohet ndërgjegjësimi për rëndësinë e cilësisë së mësimdhënies dhe mësimnxënies.

Strategjia 5 vjeçare e përmirësimit të vazhdueshëm të cilësisë ka qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë e cila shërbente si busull për të ndërtuar objektivat konkrete të performancës akademike dhe shkencore

Konkluzione të GVJ:

K.U. "WISDOM". realizon në bazë vjetore analiza mbi ecurinë e programit BSc në Psikologji. Institucioni ka ngritur NJSBC për të siguruar cilësinë në mësimdhënie dhe mbarëvajtje. Kjo njësi paraqiti një databazë dokumentacioni dhe instrumentesh monitoruese dhe vlerësuese të cilësisë, të cilat përditësohen në mënyrë periodike, me qëllim rritjen e cilësisë së vlerësimit. Vlerësimet e realizuara jo vetëm raportohen në strukturat përkatëse, por edhe përpiqen të bëjnë ndryshimet e duhura në funksionin të rritjes së cilësisë.

POLITIKAT E FORMIMIT TË STUDENTËVE

7. Programi i studimit, organizimi i tij

Pjesa përshkrimore

Terma reference: misioni dhe objektivi i programit të studimit, përmbajtja e programit, organizimi i vitit mësimor, semestrat, plani mësimor me të gjithë elementët e tij (lëndët/modulet, kreditet përkatëse, ndarja e orëve për çdo kredit në varësi të formave të studimit, orët mësimore përkatësisht në auditor/jashtë auditorit të ndara sipas formave të mësimdhënies), literatura dhe materiale të tjera mbështetëse e ndihmëse, etj

Sipas RVB dhe dokumenteve të shqyrtuara Programi i studimit “Bachelor në Psikologji” është hartuar në përputhje me Rregulloren mësimore të programit të ciklit të parë të studimit “Bachelor në Psikologji”, me Udhëzimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës Nr. 15, datë 04.04.2008 “Për Organizimin e studimeve në Institucionet Publike të Arsimit të Lartë”, Statutin dhe rregulloren e institucionit. Ai është përgatitur në përputhje me nevojat e kohës dhe për t’iu përgjigjur aspiratave për një shoqëri të zhvilluar e të integruar në strukturat evropiane. Programi i studimit është hartuar në përputhje me objektivat e programit përkatës të studimit, me planin e tij mësimor si dhe me veprimtaritë mësimore të tij. Studimet në këtë cikël realizohen me 180 kredite dhe kohëzgjatja normale e tij është 3 (tre) vite. Në përfundim të programit të studimeve të ciklit të parë studenti pajiset me diplomë “Bachelor në Psikologji”.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Viti i fillimit, qëllimet dhe objektivat e çdo programi studimi

Nga takimi që GVJ pati me pedagogët dhe studentet u vu re që, studentët informoheshin nga; përgjegjësi i Departamentit, Koordinatori i programit të studimit si dhe nga sekretaria mësimore. Studentët informohen për përmbajtjen e programit të studimit në fillim të çdo viti akademik. Koordinatori informon gjithashtu për lëndët me zgjedhje apo të detyrueshme për secilin semestër. Studentët bëjnë zgjedhjen e lëndëve dhe programit të studimit të ofruar nga Departamenti i Psikologjisë. Studentët janë të informuar për ngarkesën mësimore të programeve të lëndëve, sipas ndarjes dhe mënyrës së organizimit në të dy semestrat, detyrimin për frekuentimin në leksione seminare dhe praktiken profesionale.

Objektivat e programit fokusohen në; pajisjen e studentëve me njohuritë themelore në fushën e psikologjisë përgatitjen e studentëve për të konkuruar në tregun e punës; aftësimin e studentëve me shprehje aplikative për të ushtruar profesionin e terapistit; aftësimin në fushën e kërkimit shkencor.

Organizimi i programit të studimit (vite, semestra, javë etj.)

- 1 vit akademik ka 30 javë mësimore në auditor
- 1 Semestër ka 15 javë mësimore në auditor

Në Planet mësimore të jepet ndarja e ECTS sipas formave të mësimdhënies për çdo lëndë

Në planin mësimor të licencimit u vëzhguan dhe u pa që çdo lëndë ishte e ndarë me kredite, orë në lëksione, seminar dhe praktikë individuale. Programi është i organizuar në grupime lëndësh bazuar në një drejtim të caktuar dhe është e ndarë me module. Çdo vit akademik ka 60 kredite, çdo semseter 30 kredite dhe në total janë 180 kredite. Ndarja e lëndëve dhe krediteve është në raport të drejtë midis lëndës dhe shpërndarjes së orëve në orë mësimore dhe orë praktike. Tek anekset gjendet tabela e plote me ndarjet sipas lëndëve shoqëruar me ECTS.

Mënyra e përcaktimit të krediteve (ECTS) për format e studimit:

- Për leksionet- 1125 orë në auditor dhe 1540 orë punë e pavarur e studentit
- Për Seminaret- 495orë në auditor dhe 890 orë punë e pavarur e studentit
- Për Labororet 0 orë në auditor dhe 0 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikat lëndore 15orë në auditor dhe 10 orë punë e pavarur e studentit
- Për Praktikën Profesionale 120 orë në auditor dhe180orë punë e pavarur e studentit
- Provimi përfundimtar 60 orë në auditor dhe 90 orë punë e pavarur e studentit

Ndryshimet në Planet mësimore, krahasuar me programet mësimore të licensuara (Plotësoni Tabelën 5, Aneksi 5)

Nuk kemi ndryshime të planit mësimor aktual me atë të licensimit.

Planet mësimore të lidhura me personelin akademik përkatës

Personeli akademik i departamentit të psikologjisë mbulonte të gjitha lëndët e programit të psikologjisë. Ndarja e lëndëve me personelin akademik gjendet në tabelën 6 (në aneksin 6).

Vlerësimi për Syllabus-et dhe elementët e tyre, për çdo lëndë.

GVJ gjatë vizitës në institucion u panë disa sylabuse të lëndëve kryesore si; Psikologji zhvillimi, Bazat e këshillimit dhe psikologjisë klinike, Teoritë dhe terapitë e këshillimit në grup. Ndërtimi i sylabuseve kishte strukturën e mëposhtme:

- Emërtimi i lëndës/modulit
- Viti/semestri kur zhvillohet lënda
- Emri i pedagogut që do të zhvillojë lëndën
- Vendi që zë lënda në formimin tërësor të studentit

- Njohuritë paraprake që duhet të ketë studenti për përvetsimin e lëndës
- Çfarë njohurish dhe aftësish i jep studentit kjo lëndë
- Temat që do të trajtojnë lënda në formimin teorik dhe praktik
- Ngarkesa në orë në auditor dhe jashtë auditorit si dhe në ECTS
- Format dhe metodat e mësimdhënies të lëndës dhe raportet midis tyre
- Format e vlerësimit të studentëve
- Detyrimet e studentit për lëndën
- Literatura e detyruar dhe ajo ndihmëse

Dokumentacioni përkatës, i marrë në institucion

NUK KA

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
I - PROGRAMET E STUDIMEVE TË OFRUARA	
Standardi I. 1 - Institucioni ofron programe studimesh në përputhje me misionin dhe qëllimin e tij.	
<p>Kriteri 1 Institucioni ofron programe të akredituara të studimeve, të organizuara në module dhe të vlerësuara në kredite, sipas Sistemit Europian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS);</p> <p>Kriteri 2 Sasia mesatare e krediteve të grumbulluara gjatë një viti nga një student që ndjek një program studimi me kohë të plotë është 60 kredite;</p>	<p>Programi i studimit “Bachelor në Psikologji” që ofron Institucioni, është i akredituar, me Urdhërin Nr 188, datë 25.04.2011 të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës.</p> <p>Përsa i përket misionit dhe objektivit të programit të studimit, vumë re një përputhje të kënaqshme me objektivat mësimore të lëndëve përkatëse.</p> <p>Programi i studimit “Bachelor në Psikologji” është organizuar sipas Sistemit Evropian të Grumbullimit të Krediteve (ECTS). Ai është me 180 ECTS në total.</p> <p>Kreditet që përfiton një një student gjatë një viti akademik me kohë të plotë janë 60 ECTS.</p>
II - ORGANIZIMI, DREJTIMI DHE ADMINISTRIMI I PROGRAMEVE TË STUDIMEVE	
Standardi II.4 - Programet e studimeve të ciklit të parë janë të detajuara dhe informuese.	
<p>Kriteri 1 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për përmbajtjen e programeve të studimeve;</p> <p>Kriteri 2 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për lëndët me zgjedhje apo të detyruara për semestër;</p> <p>Kriteri 3 Njësitë kryesore, përgjegjëse për</p>	<p>Nga takimi që GVJ pati me pedagogët dhe studentet u vu re që, përgjegjësi i Departamentit, Koordinatori i programit të studimit si dhe Sekretaria informonte studentët. Studentët informohen për përmbajtjen e programit të studimeve në fillim të çdo viti akademik.</p> <p>Koordinatori informon gjithashtu për lëndët</p>

një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për ngarkesën mësimore, orët në auditor, frekuentimin/ ndjekjen e programit;

Kriteri 4 Njësitë kryesore, përgjegjëse për një program studimi të ciklit të parë, japin informacionet e nevojshme për syllabuset e detajuara për secilën lëndë, për praktikat, ushtrimet apo orët e laboratorit, etj.

me zgjedhje apo të detyrueshme për secilin semestër. Studentët bëjnë zgjedhjen e lëndëve dhe programit të studimit të ofruar nga Departamenti i Psikologjisë

Studentët janë të informuar për ngarkesën mësimore të programeve të lëndëve, sipas ndarjes dhe mënyrës së organizimit në të dy semestrat, detyrimin për frekuentimin në leksione seminare dhe praktiken profesionale.

Të gjithë syllabuset, janë të standartizuara. Ato përmbajnë informacion të detajuar për temat që do të zhvillohen përmbajtjen metodologjinë, frekuentimin bibliografinë e detyrueshme dhe të rekomanduar, etj.

Konkluzionet e GVJ:

Programi i studimit “Bachelor në Psikologji” është organizuar sipas Sistemit Evropian të Transferimit dhe Grumbullimit të Krediteve (ECTS) dhe sipas legjislacionit dhe rregullave nga MAS. Objektivat dhe misioni i tij janë në koherencë me pjesën e ndërtimit të programit dhe syllabuseve. Studimet për BSc në Psikologji realizohen në 3 vite akademike /6 semestra, me 180 ECTS në total. Studentët janë të informuar për programin, lëndët, detyrimet dhe mënyrën e vlerësimit. Përgjegjësi i departamentit dhe koordinatori janë në kontakt me ta për t'i informuar vazhdimisht për nevojat e tyre dhe të programit.

8. Mësimdhënia

Pjesa përshkrimore

Terma reference: organizimi i mësimdhënies, format e mësimdhënies, ngarkesa dhe cilësia e realizimit, kontrolli i njohurive të studentëve, metodat e mësimdhënies, teknologjitë e mësimdhënies, vlerësimi i brendshëm i mësimdhënies, aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj.

Nga vezhgimi ynë përsa i përket organizimit të mësimdhënies ajo kryhej me metoda bashkohore dhe mjete autovizive të cilat nuk mungonin me asnjë auditor. Ngarkesa mësimore ishte e ndarë sipas moduleve dhe krediteve të lëndëve përkatëse. Cilësia e mësimdhënies lidhet ngushtë edhe me fushën e ekspertizës apo interesave kërkimorë shkencorë të pedagogëve, të cilat ishin të pasqyruara në artikuj dhe botime shkencore konferenca brënda dhe jashtë vendit. Kontrolli i dijeve të studentëve kryhej nëpërmjet provimeve, detyrave dhe eseve të cilat përgatiteshin në auditor. Studentët ishin pjesë aktive në jetën e institucionit dhe kërkimet shkencore. Kontrolli i njohurive është në përputhje me standartet e vendosura nga institucioni.

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Llojet e Formave të mësimdhënies, për lëndët/modulet:

Grupi i GVJ nga takimi me studentët dhe pedagogët u informua mbi llojin e mësimdhënies që përdorej në këtë institucion. Mësimdhënia bazohej në mbajtjen e leksionit nga pedagogët, organizimin e seminareve ku në fokus ishte studenti dhe njohuritë e tij. Përdorshin role play për të ilustruar rastet. Studentët përfshiheshin në praktika lëndore dhe profesionale.

- Leksione 1110 orë leksioni
- Seminare 495 orë seminari në auditor
- Ushtrime në shumicën e orëve të seminarit përdorshin ushtrime si role play apo diskutime rastesh
- Praktikë lëndore 15 orë
- Praktikë profesionale 120 orë
- Etj

Format e kontrollit të njohurive

Format e kontrollit të njohurive realizoheshin përmes provimeve të ndërmjetme 10%, detyrat e kursit apo eseve 10%, pjesëmarrjes në auditor 10% dhe provimit përfundimtar 70 %. Studentët ishin të informuar që në fillim të vitit akademik dhe semestrit për këto forma vlerësimi

Aktivizimi i studentëve në komponentët e aktivitetit të njësisë etj

Studentët merrnin pjesë në aktivitetet e njësisë. Këto aktivitete ishin që nga karakteri i mbledhjeve të ndihmave për një rast social; marrja pjesë në diskutime për përmirësimin e punës së njësisë dhe kërkime apo projekte të organizuara nga njësia apo fakulteti.

Në punimet e pedagogëve ishin përfshirë 10 studentë; në projekte të departamentit ishin përfshirë 20 studentë; në projekte në rag fakulteti ishin përfshirë 14 studentë.

Nga takimet që patëm me pedagogët dhe studentët u vu re që ata ishin koherentë me njëri tjetrin. Studentët u shprehën shumë të kënaqur me mënyrën e mësimdhënies dhe raportin që kanë ndërtuar me pedagogët.

9. Studentët

Pjesa përshkrimore

Terma reference: procedurat e pranimit të studentëve, cilësia në hyrje e studentëve, numri i studentëve në hyrje dhe në dalje në vite, koha mesatare e zgjatjes së studimeve, kalueshmëria e studentëve dhe problemet që lidhen me të, statistika, punësimi i të diplomuarve, komunikimi me ish-studentët e diplomuar, informimi i studentëve.

Studentët që do të regjistrohen për herë të parë në programin mësimor “Bachelor në Psikologji”i nënshtrihen procedurës së përzgjedhjes. Përzgjedhja bëhet nga një komision i ngritur nga dekani. Kandidati është i detyruar të paraqesë dokumentin original ose fotokopje të noterizuar të tij. Departamenti bën vetë fotokopjimin dhe depoziton në dosjen e kandidatit një fotokopje të thjeshtë të dokumentit të paraqitur. Komisioni, si rregull, bën klasifikimin e kandidatëve, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur nga ata si dhe nëpërmjet intervistimit a testimit, kur kjo gjykohet e nevojshme. Komisioni përzgjedhës shpall listën e kandidatëve që pranohen të ndjekin studimet në këtë program duke caktuar edhe afatin përfundimtar të regjistrimit. Me kandidatin që është pranuar të ndjekë studimet, K.U. “WISDOM”, lidh një marrëveshje regjistrimi, në të cilën parashikohen detyrimet e ndërsjellta të palëve. Në emër të K.U. “WISDOM”, marrëveshja e regjistrimit nënshkruhet nga kancelari. K.U. “WISDOM”. pranon kërkesat e kandidatëve që dëshirojnë të vazhdojnë studimet në ciklin e parë të studimeve të cilët plotësojnë këto kritere :

- Disponojnë diplomën e Maturës Shtetërore së bashku me çertifikatën e notave ose diplomën/dëftesën e shkollës së mesme të fituar jashtë vendit të vlerësuar të barazvlefshme me të në Shqipëri.
- Kandidatët që e kanë përfunduar shkollën e mesme përpara vitit 2011 duhet të dorëzojnë Dëftesë pjekurie të Shkollës së Mesme;
- Vërtetojnë me dokumente zyrtare transferimin nga një shkollë universitare publike ose jopublike që ushtron veprimtarinë e saj brenda territorit të Republikës së Shqipërisë ose jashtë tij.
- Pranojnë të paguajnë tarifën e studimeve.

Numri i studentëve të regjistruar aktualë për këtë program studimi sipas të dhenave të marra në sekretarinë mësimore është si më poshtë:

Viti Akademik	Programi I studimit	Te regjistruar per here te pare ne Viti I-rë	Te transferuar ne Viti II-të	Te transferuar ne Viti III-të	Total Studente
2014-2015	Psikologji	7	16	73	96
2015-2016	Psikologji	21	0	17	38
2016-2017	Psikologji	13	3	0	16
totali		41	19	90	150

Vlerësimi i Tregues të matshëm:

- Procedurat e pranimit të studentëve**

Studentët që do të regjistrohen për herë të parë në programin mësimor “Bachelor në Psikologji” i nënshtrohen procedurës së përzgjedhjes. Përzgjedhja bëhet nga një komision i ngritur nga dekani. Kandidati është i detyruar të paraqesë dokumentin origjinal ose fotokopje të noterizuar të tij. Departamenti bën vetë fotokopjimin dhe depoziton në dosjen e kandidatit një fotokopje të thjeshtë të dokumentit të paraqitur. Komisioni, si rregull, bën klasifikimin e kandidatëve, mbështetur në dokumentacionin e paraqitur nga ata si dhe nëpërmjet intervistimit a testimit, kur kjo gjykohet e nevojshme.

Dokumentacioni që kërkohet në këtë fazë përbëhet nga:

- formulari i aplikimit për në K.U. “WISDOM”, i plotësuar nga kandidati;
- dokumenti zyrtar i përfundimit të Maturës Shtetërore;
- dokumenti i identifikimit;
- dokumenti që vërteton pagesën e tarifës së aplikimit.

Komisioni përzgjedhës shpall listën e kandidatëve që pranohen të ndjekin studimet në këtë program duke caktuar edhe afatin përfundimtar të regjistrimit. Me kandidatin që është pranuar lidhet një marrëveshje regjistrimi, në të cilën parashikohen detyrimet e ndërsjellta të palëve.

Cilësia në hyrje dhe në dalje e studentëve

Cilësia e studentëve që janë regjistruar për herë të parë dhe që kanë dalë ka ruajtur një koherencë në terma të notave. Ato variojnë më notën më të ulët të regjistruar 6.2 deri në një mesatare maksimale 8.

Studentë të regjistruar në vitin e Parë (për herë të parë). Nota Mesatare

Studentë të regjistruar për herë të parë në vitin a parë për vitin akademik 2016-2017 janë 13 dhe nota mesatare e tyre 7.4

Studentë të diplomuar në vitin e fundit (pa vite përsëritëse). Nota Mesatare

Nuk ka studentë aktualë në vit të tretë për këtë program studimi, studentët e fundit të diplomuar janë në vitin akademik 2015-2016 pa vite përsëritëse. Numri i të diplomuarve është 35, nota mesatare e tyre 7.6

Mobiliteti i studentëve brenda sistemit të arsimit të lartë në vend

Mobiliteti i studentëve në këtë institucion nuk ka ardhur si pasojë e ndonjë lëvizjeje të strukturuar dhe mirëmennduar por për shkak të transferimit të studentëve në vitet akademike 2014-2017. Mobilitet tjetër nuk ka pasur ndonëse studnetët janë informuar për mundësitë për mobilitet.

Të dhëna për punësimin e studentëve

Janë punësuar rreth 128 studentë.

Numri total të diplomuarve-

Numri total i të diplomuarve bashkë me transferimet që ka pasur në vitin 2014-2015 është 65 studente.

Numri total i të punësuarve (në përputhje me diplomën)

Sipas një studimi të kryar nga vetë institucionii për të kuptuar më shumë për punësimin e studentëve të tyre u vu re që vetëm 20% e tyre punonin në sektorin publik apo privat sipas diplomës që kanë.

☑ Numri total i të punësuarve (jo në përputhje me diplomën)

Numri i studentëve të punësuar jo sipas diplomës është 75 %. 15 % janë punësuar në sektorin publik dhe 60 % në sektorin privat.

Edhe sipas RVB dhe asaj që u vërtetua, ngarkesa mësimore e studentëve parashikohet në përputhje me rregulloren e çdo programi studimi. Kreditet e një disipline fitohen vetëm pas vlerësimit të studentit me notë kaluese. Në rastin e disiplinave të përbëra nga 2 module, studenti vlerësohet me notë përfundimtare duke llogaritur mesataren e ponderuar për 2 modulet. Krahas leksioneve dhe seminareve, studentëve u ngarkohen të kryejnë jashtë auditorit edhe punime të pavarura si detyra kursi, ese etj. Para provimeve dhe formave të tjera të testimit me studentët zhvillohen konsultime individuale dhe në grup. Në fillim të vitit akademik caktohet një pedagog kujdestar për secilin grup të programit të studimit “Bachelor në Psikologji”.

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
IV - INSTITUCIONI MBRON TË DREJTAT E STUDENTËVE	
Standardi IV.1 - Institucioni ndjek një politikë të mirëpritjes së studentëve të rinj.	
<p>Kriteri 1 Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi.</p> <p>Kriteri 2 Institucioni i Arsimit të Lartë propozon kriteret të veçanta për përzgjedhjen e kandidatëve, të cilët kanë mbaruar Maturën Shtetërore, për t’u pranuar në ciklin e parë të studimeve.</p>	<p>Pranimi në ciklin e parë të studimeve bëhet në përputhje me ligjin nr. 9741, datë 21.5.2007, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar dhe aktet nënligjore në fuqi</p> <p>Për tu regjistruar në këtë program studimi janë të nevojshme këto kriteret: Nota mesatare e shkollës së mesme mbi 6, (për të gjithë vitet) që është 70 % e vlerësimit përfundimtar.</p> <p>Nota mesatare e grup lëndëve të përcaktuara nga institucioni si prioritet për fushën (Filozofi, Psikologji dhe gjuhë e huaj), që zë 20% të vlerësimit.</p> <p>Një komision i ngritur ad-hoc interviston kandidatët. Ky proces zë 10% të vlerësimit.</p>
Standardi IV.2 - Institucioni informon studentët në lidhje me politikat e punësimit.	
Kriteri 1 Studentët informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit,	Studentët, që në fillim të vitit akademik, përmes përgjegjëses së departamentit,

organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimeve;

Kriteri 2 Studentët vlerësojnë pedagogun e çdo lënde, në përfundim të semestrit;

Kriteri 3 Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës;

Kriteri 4 Studentët informohen mbi mundësitë për punësim pas diplomimit në këtë program studimi.

koordinatores së programit dhe sekretarisë mësimore, informohen në mënyrë të detajuar për programin e studimit, organizimin dhe kohëzgjatjen e programit të studimit.

Studentët vlerësojnë mbarëvajtjen e procesit mësimorpedagogun mbi, aftësitë akademike, etikën, komunikimin etj, në fund të çdo lënde.

Zyra e Burimeve Njerëzore, e Karrierës dhe Jetës Studentore ndihmon studentët me praktikën dhe prezantimin me institucionet më të përshtatshme për praktikën profesionale. Studenti zgjedh pasi njihet me to.

Standardi IV.3 - Institucioni disponon statistika në lidhje me numrin e studentëve që ndjekin programet e studimeve të ciklit të parë.

Kriteri 1 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e të diplomuarve, në ciklin e parë;

Kriteri 2 Institucioni disponon statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik në të cilin zhvillohet programi i studimeve;

Kriteri 3 Institucion disponon të dhëna për ecurinë e studentëve gjatë zhvillimit të programit të studimeve që nga pranimi, deri në diplomim.

K.U. "WISDOM". ka statistika të qarta lidhur me numrin e të diplomuarëve në programet e studimit në ciklin e parë. Studentë të diplomuar në K.U "Wisdom" ndër vite, deri në vitin 2016 janë 146 sipas të dhënave të cilat na u vunë në dispozicion gjatë vizitës në Sekretarinë mësimore.

Sekretaria mësimore mban dhe raporton statistika vjetore për numrin e studentëve të regjistruar në programet e studimeve të ciklit të parë, tërheqjet nga programi, si dhe largimet para përfundimit të programit apo mospërfundimin me sukses të vitit akademik, në të cilin zhvillohet programi i studimeve.

Pedagogët dhe njësitë e tjera që bashkëpunojnë me departamenin mbajnë shënime elektronike për zhvillimin e studentëve në fushën e studimeve psikologjike.

Standardi IV.4 Institucioni angazhon personelin e tij për përkujdesjen ndaj studentëve.

Kriteri 1 Institucioni u ofron këshillim karriere studentëve, ndjek progresin e tyre dhe i ndihmon ata në çështjet që kanë të bëjnë me procesin mësimor;

Kriteri 2 Institucioni (nëpërmjet zyrës për këshillimin e karrierës) ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata

Pedagogët udhëheqës së praktikës dhe zyra për karrierën ofronin këshillim karriere për studentët. Ky është një proces i ri në vend, por institucioni duket se po zhvillohet mirë në këtë drejtim. Kjo njësi i ndihmon studentët të përgatiten në krijimin e një portofoli për

do të zhvillojnë praktikën profesionale, në rastet kur parashikohet një e tillë.

menaxhimin e karrierës; përballimi intervistave; komunikimi me organizatën pritëse; dhe vlerësimin në fund të praktikës.

Institucioni nëpërmjet Zyrës së Burimeve Njerëzore, e Karrierës dhe Jetës Studentore ndihmon studentët në përzgjedhjen e institucionit në të cilin ata do të zhvillojnë praktikën profesionale. Institucioni ka marrëveshje me biznese për kryerjen e praktikës, për studentët e programit të studimit “Bachelor në Psikologji”

Konkluzionet e GVJ

Institucioni kriteret e pranimit të studentëve i bazonte në udhëzimet e MAS, dhe në disa kriterat të personalizuar për fushën e studimit. Studentët informoheshin përmes disa burimeve për pritshmëritë akademike, detyrimet dhe të drejtat. Studentëve u ofrohet shërbimi i këshillimit të karrierës lidhur me praktikën dhe zhvillimin akademik në sipas kërkesave të tregut të punës dhe prirjeve personale. Sipas vëzhgimeve të GJV institucioni dispononte statistika të studentëve për çdo vit akademik. Institucioni disponon statistika për numrin e të diplomuarëve, të cilat raportohen çdo vit në MAS.

Numri i vogël i studentëve, jo sepse kriteret e pranimit janë të paarritshme, por sepse duket që kjo IAL nuk ka bërë rekrutim të mirë të studentëve në fushën e psikologjisë, që do të rriste ndjeshëm cilësinë e mësimdhënies dhe të formimit të studentëve.

KËRKIMI SHKENCOR NË FUNKSION TË PROGRAMIT TË STUDIMIT.

10. Kërkimi shkencor **Pjesa përshkrimore**

Terma reference: politikat e kërkimit shkencor në këtë program studimi, botimet në vite, projektet e fituara dhe të realizuara, pjesëmarrja në aktivitetet brenda dhe jashtë vendit, aktivitetet e organizuara nga njësia, lidhja e kërkimit me mësimdhënien.

Për të promovuar kërkimin shkencor, është përcaktuar fondi për Kërkimin shkencor, që ka mbuluar koston e lëvizjes së kërkuesve shkencorë dhe profesoratit drejt projekteve dhe/apo prezantimeve kërkimore, duke mbuluar tarifën e aplikimit në disa aktivitete shkencore, publikimeve të disa revistave shkencore dhe botimeve të llojit “Conference Proceedings”, si edhe organizimin e ngjarjeve shkencore në IAL dhe jashtë saj. Stafii pedagogjik i Programit të Studimit Bachelor në Psikologji në kuadër të rritjes personale akademike, në formë periodike, raporton pranë Njesisë së Kërkimit Shkencor dhe

Marrëdhëniet me Jashtë mbi aktivitetin personal kërkimor-shkencor, duke plotësuar formatin e aktivitetit shkencor periodik dhe vjetor

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

Të dhëna për kërkimin shkencor

K.U. "WISDOM", në nivel institucional, ka organizuar disa aktivitete me karakter shkencor me partnerë të ndryshëm, siç janë "Qendra Ndërkombëtare për Studime Ligjore" në Austri, Ministria e Integritit, Ministria e Turizmit, Ministria e Mjedisit, Dhoma Gjermane e Tregtisë dhe Industrisë, Kolegji European i Shkupit, Universiteti i Tiranës dhe Shtëpi botuese të ndryshme etj

Numri i botimeve nga personeli akademik efektiv i IAL

Numri i botimeve nga personeli akademik është 45

Numri i projekteve kërkimore të fituara/ NUK KA

Numri i projekteve të zbatuara- 1 projekt të zbatuar

Numri i aktiviteteve shkencore të organizuara nga IAL

Aktivitete shkencore për programin e studimit janë 17 konferenca shkencore (më poshtë janë të listuara disa prej tyre, kjo listë është marrë nga RVB). Janë organizuar 4 leksione të hapura; 1 konferencë studentore ndëruniversitare; 3 seminare të hapura studentore.

Konferenca Kombëtare me temë "Roli i Arsimit të Lartë në funksion të integritit në BE", në bashkëpunim me Ministrinë e Integritit, më 28 Maj, 2015.

Konferenca Kombëtare Shkencore organizuar nga Fakulteti i Shkencave Ekonomike dhe Shoqërore në mjediset e K.U. "WISDOM", më 15 Prill 2016, me temë: "Aktualiteti Ekonomik në Shqipëri dhe Progresi për Integrim në Bashkimin European".

Konferenca Kombëtare Shkencore me temë: "Roli i Psikologjisë në Kontekstin Shoqëror" me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Universitetit të Tiranës, Prof. Dr. Nikoleta Mita dhe Prof. Dr. Edlira Haxhiymeri nga Fakulteti i Shkencave Shoqërore të Universitetit të Tiranës, më 4 Maj, 2016.

Konferenca Shkencore Kombëtare me temë: "Sfida të Shërbimit Psikologjik në Shqipëri" me pjesëmarrjen e përfaqësuesve të Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Shkencave Shoqërore dhe përfaqësues të Ministrisë së Mirëqenies Sociale dhe Rinisë.

Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore brenda IAL

Numri i kërkimit shkencor me procesin mësimor

Janë realizuar nga pedagogët e departamenti 10 kërkime shkencore (doktoratura kryesisht) në të cilat ishin përfshirë 10 studentë.

Numri i studentëve të përfshirë në kërkimin shkencor

14 studentë janë përfshirë në kërkimin shkencor që është organizuar në rang fakulteti.

Numri i Çmimeve Kombëtare/ NUK KA

Dokumentacioni përkatës i marrë gjatë vizitave

U panë dokumentat që vërtetoin organizimin e këtyre aktiviteteve shkencore.

Grupi i vlerësimit të jashtëm pasi pa dokumentacionin lidhur me kërkimin shkencor të këtij institucioni konstatoi se kërkimi shkencor është kryesisht i fokusuar në organizimin e konferencave apo studimeve. *Kërkimi shkencor mbetet një fushë për tu zhvilluar më tej, jo vetëm në nivel individual por edhe në përfshirjen më aktive të studentëve në kërkime shkencore si edhe në kërkime shkencore ndërinstucionale.*

11. Bashkëpunimi kombëtar, ndërkombëtar dhe marrëdhëniet me publikun

Pjesa përshkrimore

Terma reference: bashkëpunimi me institucionet e tjera në nivel lokal, kombëtar apo ndërkombëtar, mobiliteti i personelit akademik në secilin nga nivelet e sipërpërmendura, pjesëmarrja në programe kombëtare dhe ndërkombëtare, lidhjet me komunitetin e biznesit dhe me tregun e punës.

K.U. "WISDOM", ka nënshkruar Memorandumin e Mirëkuptimit me Institucionin e Arsimit të Lartë, MBS College of Greece, i cili është filial i Staffordshire University në Britaninë e Madhe. Marrëveshja e nënshkruar në vitin 2015, ka si qëllim kryesor mobilitetin e studentëve të K.U. "WISDOM". drejt MBS College of Greece në programet e studimit në Drejtësi, Ekonomik dhe Psikologji. Mobiliteti i studentëve realizohet në kuadër të njohjes së programeve të studimit në K.U. "WISDOM". nga MBS College of Greece dhe sipas sistemit të transferimit të krediteve, ECTS, European Credit Transfer System. Kjo marrëveshje parashikon aktivitete akademike dhe shkencore të përbashkëta në nivel institucional dhe programi studimi, duke përfshirë këtu shkëmbimin e eksperiencës në mësimdhënie për lektorët e dy IAL-ve; organizimin e konferencave shkencore të përbashkëta dhe publikimin e produkteve shkencore. Aktualisht, ky institucion regjistron 36(tridhjetë e gjashtë)marrëveshje bashkëpunimi, binjakëzime dhe memorandume mirëkuptimi në nivel institucional, me shkolla të larta universitare, akademi, agjensi punësimi, organizata jofitimprurëse dhe shoqata të ndryshme, ku përfshihet edhe Programi i Studimit "Bachelor në Psikologji".

Vlerësimi i Treguesve të matshëm:

- Të dhëna për bashkëpunimin kombëtar dhe ndërkombëtar
 - **Numri i pjesëmarrësve si partnerë në projekte Kombëtare apo ndërkombëtare**
Pjesëmarrja në projekte kombëtare ka qenë vetëm një herë. Pavarësisht aplikimeve të ndryshme që kanë pasur dhe vazhdojnë të kenë.
 - **Numri i Leksioneve dhe seminareve me lektorë të huaj** – 1 Lektor i huaj

- **Numri i pjesëmarrësve në trainime fushën e kërkimit shkencor jashtë vendit/ NUK KA**

- **Mobiliteti i studentëve nga dhe drejt IAL –**

Ka pasur rreth 113 prurje tëstudnetëve nga IAL-të që u mbyllën për shkak të reformës në arsim. Ka përpjekje për të përfshirë studentët në mobilitete të tjera jashtë vendit.

- **Infrastruktura në funksion të kërkimit shkencor**

Institucioni ka ndërtuar këtë infrastrukturë për kërkimin shkencor: Njësi Shkencore dhe Marrëdhëniet me Jashtë; Institut Kërkim Zhvillimi; Klinikë Ligjore; Bibliotekë; Abonim i bibliotekës online; Laborator IT; Salla Konferencash; Trajnim i brendshëm i stafit akademik: dhe mbështetje e stafit akademik kur kanë prezantime brenda apo jashtë vendit.

- **Numri i pjesëmarrësve në aktivitete shkencore Jashtë IAL/ jashtë vendit dhe prezantime**

Institucioni numëron 65 pjesëmarrje në aktivitete shkencore jashtë IAL apo vendit.

- Komunikimi dhe bashkëpunimi me institucionet e tjera shtetërore, organizata profesionale, komunitetin e biznesit, tregun e punës dhe aktorë të tjerë shoqërorë të rëndësishëm për arsimin e lartë:

- **Institucionet qeveritare bashkëpunuese**

Institucioni bashkëpunon me Akademinë e Shkencave; Universitetin e Tiranës; Drejtorinë e përgjithëshme tëçerdheve dhe kopështeteve për praktikat e studnetëve.

- **Organizatrat Profesionale**

Kanë marrëveshje bashkëpunimi me disa institucione publike si: “Drejtoria e Përgjithshme e Kopshteve dhe Çerdheve”, Fondacioni “Fëmijët Shqiptarë”, Qendra “Pëllumbat”. Gjithashtu edhe me Universitete të tjera jashtë vendit si Universiteti i Terramos; “Universiteti i Padovas” “Qendra Ndërkombëtare për Studime Ligjore” në Austri; “Kolegji Universum”, Kosovë; “MBS, College of Crete”, Greqi; “TBU, Tirana Business University” “Norman Academy” dhe “The Ruggero II University”; “Instituti European për Menaxhim, Drejtësi dhe Diplomaci”, Shkup, Maqedoni; “Kolegji European i Kosovës” Kolegji Universitar `Qiriazi`; “Universiteti Bujqësor`; K.U. `Marin Barleti`; Instituti për Studime Politike dhe Ndërkombëtare, Shkup.

- **Komuniteti i biznesit, tregu i punës**

U pa dokumentacioni i bashkëpunimit me biznese si: Fondacioni “Noah”, Firma “Coca-Cola Bottling”; Hotel “Diplomat”; “Shoqata vullnetare për zhvillim dhe Solidaritet”, “Europe Agency”.

- Dokumentacioni përkatës/ N/a**

Vlerësimi sipas Standardeve

Standardet/kriteret	Përmbushja e standardeve
---------------------	--------------------------

**VII - INSTITUCIONI GARANTON MARRËDHËNIE BASHKËPUNIMI,
TË BRENDSHME DHE TË JASHTME**

Standardi VII.1 - Institucioni garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi mes personelit të vet.

Kriteri 1 Institucioni, për hartimin dhe mbikëqyrjen e programit, nxit bashkëpunimin ndërmjet personelit brenda institucionit nëpërmjet shkëmbimit të informacionit;

Kriteri 2 Institucioni, nëpërmjet ndarjes së detyrave mes personelit Brenda institucionit, marrjes së përgjegjësiive respektive dhe analizës së vazhdueshme të punës së tyre, garanton marrëdhënie të frytshme bashkëpunimi.

Institucioni ka bashkëpunim ndërmjet strukturave të institucionit dhe jashtë tij. Revistën Wisdom, organizimi i konferencave, simpoziumeve leksioneve të hapura, aktivitete shkencore janë tregues të këtij bashkëpunimi.

Strukturat e institucionit kishin të ndara qartë detyrat kur përfshiheshin në projekte apo kur aplikonin për fonde në institucione brenda apo jashtë vendit.

Standardi VII.2 - Institucioni garanton marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj.

Kriteri 1 Institucioni për realizimin e objektivave të programeve të studimeve dëshmon se ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me institucionet homologe jashtë vendit dhe aktorët e biznesit vendas ose të huaj;

Kriteri 2 Institucioni ka vendosur marrëdhënie bashkëpunimi me punëdhënësit për kryerjen dhe mbikëqyrjen e praktikës, në varësi të programeve të studimeve që ofrojnë;

Kriteri 3 Institucioni organizon trajnime profesionale të mëtejshme në bashkërendim me punëdhënësit;

Kriteri 4 Institucioni bën një raport analitik të përfitimeve nga marrëveshjet kontraktuale në funksion të realizimit të programeve të studimeve.

Programi i plotëson kriteret e këtij standardi dhe është në mbështetje të zhvillimit dhe bashkëpunimit me institucionet e huaja.

Institucioni ka marrëveshje bashkëpunimi me disa kompani private dhe institucione shtetërore për praktikën e studentëve.

Studenti që përfshihet në praktikë ndiqet me kujdes nga koordinatori në bashkëpunim me personin përgjegjës të institucionit në të cilën kryhet praktika. Shihen edhe mundësitë e punësimit

Në fund të vitit akademik bëhet një raport analitik për ecurinë e marrëveshjeve të bashkëpunimit në funksion të realizimit të programeve të studimit.

Konkluzionet e GVJ. Plotësohen kriteret bazë. Ka bashkëpunim me institucione të ngjashme brenda dhe jashtë vendit. Ka marrëveshje bashkëpunimi me organizata që ofrojnë shërbime të cilat ofrojnë praktikën e studnetëve. Revista e institucionit është vlerë e shtuar për institucionin, ndonëse cilësia duhet përmirësuar me kërkime të mirëfillta shkencore me disa autorë nga disa institucione. *Sugjerohet të rritet mundësia dhe bashkëpunimi për të kryer studime të përbashkëta që do të ndihmonin rritjen e cilësisë së kërkimit dhe të përfshirjes së studnetëve në kërkimin shkencor.*



ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR VLERËSIMIN E PROGRAMIT TË STUDIMIT

I. ANALIZA PËRMBLEDHËSE PËR PLOTËSIMIN E REKOMANDIMEVE NGA AKREDITIMI I PARË

(Grupi shprehet për plotësimin/mosplotësimin/plotësimin e pjesëshëm të rekomandimeve)

- a) Të vlerësohet mundësia e rritjes së kontakteve edhe me universitete të tjera, vendëse dhe të huaja, publike dhe private, në mënyrë të veçantë europiane dhe amerikane që ofrojnë sidomos studime në psikologji për të qenë në korrent të ndryshimeve që pëson kurrikula e kursit në përshtatje me kërkesat e tregut të punës (mundësisht të ketë një marrëveshje bashkëpunimi me fokus programet e studimeve në psikologji me Universitetin e Tiranës).
- **Ky kriter është plotësuar.** Ka numër të shtuar të bashkëpunimit me disa institucione brenda dhe jashtë vendit. Institucionë universitare; të kërkimit shkencor; organizata që ofrojnë mundësinë e praktikave; lektorë të huaj; biznese që mund të ofrojnë punë për studentët gjatë kohës së realizimit të studimeve.
- b) Të rishikohen kriteret e punësimit të pedagogëve të rinj me synim nxitjen dhe mbajtjen e tyre në punë për afate të gjate kohore. Nxitja dhe inkurajimi për pjesëmarrje dhe specializime brenda dhe jashtë vendit si dhe nëpërmjet një angazhimi me të plotë në punët e universitetit.
- **Ky kriter është plotësuar,** Është punuar seriozisht për këtë rekomandim. Staf i pedagogjik ka kontratë të përcaktuar dhe të qartë. Kriteret e punësimit të stafit janë të qarta. Staf i pedagogjik mbështetë në preanizatimin e kërkimeve të tyre brenda dhe jashtë vendit. Mbështetja e stafit duhet të jetë e vazhdueshme, sepse natyra e punës dhe dinamikat e zhvillimit të kërkimit shkencor janë të tilla. Gjithashtu, mund të shihet shtimi me staf të brendshëm akademik për të ulur ngarkesën mësimore të stafit të brendshëm. Pedagogët e jashtëm mund të shtohen, edhe për rritjen e cilësisë dhe bashkëpunimit ndër institucional.
- c) Të shihet mundësia e vendosjes së kriterëve seleksionuese në pranimin e studentëve në programet e studimit Bachelor. Kjo do të ndikonte në rritjen e cilësisë.
- **Ky kriter është plotësuar,** Është arritur, përveç rregullorës së MAS, insitucioni ka vendosur kritere bazuar në standartet e zhvillimit të insitucionit. Kriteret seleksionuese janë në koherencë me natyrën e studimeve dhe njohurive që një aplikant duhet të ketë për të studiuar psikologji.
- d) Të shihet mundësia e pasurimit të fondit të bibliotekës me botime në gjuhën shqip dhe në gjuhë të huaja sipas fushave të studimit.
- **Ky kriter është plotësuar pjesërisht** Është pasuruar, por jo shumë në fushën e psikologjisë në gjuhë të huaja. Në bibliotekë ka thuhet të gjitha botimet shqip në këtë fushë, por botimet në gjuhë të huaja edhe në bibliotekën online ishin të kufizuara në psikologjinë ligjore. Të shihet

mundësia e organizimit të një jete më active dhe të gjallë të studentëve pas mësimit.

- **Ky kriter është plotësuar**, ka infrastrukturë për studentët. Janë ngritur Klubet e studentëve. Cilësia e funksionimit të këtyre klubeve është për tu zhvilluar me kalimin e kohës duke iu përshtatur kërkesave të klubeve simotra në vendet e tjera.

e) Është imediate zgjidhja e çështjes së kampusit të universitetit që do t'i jepte një vlerë më të madhe këtij institucioni.

- **Ky kriter është plotësuar**. Nëse do të ketë një shtim të ndjeshëm të numrit të studnetëve në këtë fushë, ndoshta duhet zgjeruar kampusi sërish. Por në kushta aktuale, kriteri është mëse i plotësuar.

f) Duhet të shihet mundësia e ngritjes së një klinike për punën me studentët.

Ky kriter është i paplotësuar. Rekomandohet ngritja e një klinike psikologjike për ndihmë studentëve; praktika mësimore dhe që të ofrohet shërbimi psikologjik për njerëz që mund të kenë nevojë. Mund të shihet edhe si burim të ardhurash për institucionin.

II. ANALIZA PËRMBLEDHËSE E RVJ SIPAS METODËS SËOT (STRENGTHS-PIKAT E FORTA, WEAKNESSES- PIKAT E DOBËTA, OPPORTUNITIES-MUNDËSITË, THREATS-PENGESAT).

a. Pika të forta:

1. K.U "Wisdom University" ka treguar se është në gjendje të rritet profesionalisht në mënyrë progressive, si në terma të programve; rekrutimit të stafit ashtu edhe të kushteve fizike.
2. Stafi KU "Wisdom University" është i përkushtuar dhe me komunikim shumë të mirë me studentët dhe mes tyre.
3. Strukturat e ngritura për sigurimin e brendshëm të cilësisë dhe zyra e karrierës janë të qëndrueshme dhe funksionale. Dhe në funksion të studentit
4. Politikat e ndjekura ndër vite nga Institucioni ndaj studentëve ka qenë dhe do të jenë mbështetëse dhe ndihmuese. Institucioni ofron bursa për studentët me nevoja ekonomike dhe për ata të ekselences.
5. Marrëveshjet e bashkëpunimit në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, kanë rritur mundësinë e projekteve të përbashkëta; kërkimeve shkencore të përbashkëta; prezantimin e cilësisë së studentëve etj.
6. Studentët kanë krijuar organet e tyre si dhe klubet studentore të cilat i përfshijnë ata në aktivitete të ndryshme.
7. Mjedisi i punës që institucioni ka krijuar ofron mundësi të barabarta dhe jodiskriminuese për personelin akademik dhe administrative.

b. Pika të dobëta:

Duke u bazuar edhe në RVB, GVJ konstaton si pika për tu përmirësuar:

1. Numri i vogël i studentëve, jo sepse kriteret e pranimit janë të paarritshme, por sepse duket që kjo IAL nuk ka bërë rekrutim të mirë të studentëve në fushën e psikologjisë, që do të rriste ndjeshëm cilësinë e mësidhënies dhe të formimit të studentëve.
2. Stafi i brendshëm i departamentit është ende i pakët në numër për të mbuluar tërësisht dhe cilësisht lëndët që i përkasin fushave të ndryshme. Shtimi me staf të jashtëm është njëmundësi për të sjellë cilësi si edhe për të shkëmbyr përvoja.

3. Mungesa e një klinike për shërbimin psikologjik kufizon formimin e shprehive aplikative të pedagogëve dhe studentëve. Kjo linikë mund të shihet edhe si mundësi për shtim të ardhurash përmes shërbime psikologjike për institucionin dhe stafin akademik.
4. Mungesa e një biblioteke online të pasur me tituj në fushën e psikologjisë prek rritjen akademike të pedagogëve dhe studentëve.

c. Mundësitë:

1. Zgjerimi i programe cikleve të studimeve;
2. Mundësitë për tu angazhuar në më tepër projekte universitare e përfshirje të studentëve dhe stafit akademik edhe përmes bashkëpunimit me institucionet vendase dhe të huaja që tanimë I kanë barë marrëveshjet.
3. Mundësi për çeljen e një klinike psikologjike, që do i ndihmontë të thellonin shprehitë aplikative dhe një mundësi për të rritur të ardhurat;
4. Shtimi i mundshëm i burimeve financiare nëpërmjet projekteve dhe mbështetjes nga buxheti e shtetit, në përputhje me Ligjin e ri.

d. Pengesat:

1. Mënyra elektronike e detyruar e përzgjedhjes së degëve të studimit apo universiteteve mund të sjellë vështirësi dhe probleme në të kuptuarit e zhvillimit të procesit apo edhe të përzgjedhjes nga një pjesë e të rinjve që aplikojnë për të ndjekur studimet universitare. Si rrjedhojë këto paqartësi mund të përkthehen në kosto dhe të rrezikojnë qëndrueshmërinë financiare të institucionit;
2. Konkurrenca nga Fakultetet e IAL-ve të tjera mund të shihet shpesh herë si mundësi dhe rrjedhimisht si faktor i largimit të stafit akademik apo administrativ;
3. Mungesa e fondeve për kërkim shkencor edhe nga donator të huaj.


**SUMMARY ANALYSIS OF EXTERNAL EVALUATION REPORT (EER)
ACCORDING TO SWOT (Strengths, Weaknesses, Opportunities and Threats)
METHOD**

a. Strengths

1. Wisdom University has shown that it is capable for a professional growth in a progressive way, in terms of curricula; recruiting staff as well as in infrastructure.
2. The staff at the KU Wisdom University is dedicated and has established a good communication standard among each other and the students.
3. The operational structure that ensures the quality along with the career office are well established and functional, and also helpful to the students.
4. The Institution policies throughout the years have been supportive and helpful to the students. The institution offers grants and scholarships to excellent students and to those who need financial aid.
5. The cooperation agreements both in national and international level, have increased the possibility for mutual projects, mutual scientific researches and presenting the quality of the students abroad, etc.
6. Students have created their own unions and clubs and teams which are included in extracurricular activities.
7. They provide a workplace that offers equal employment opportunities for both the faculty and the administrative staff.

b. Weaknesses

Based on the RVB, the GVJ reviews some points as weaknesses:



1. The small number of students, and this is not because admission procedures are difficult, but the IAL has not worked to recruit new psychology students, that might increase considerably the quality of education and training.
2. The small number of full time academic staff has led to difficulties while trying to cover all the academic programs that are required. Hiring extra faculty staff will help for a more qualitative education and to exchange experiences.
3. The lack of a clinical space for psychological services limits the cultivation of proper skills in both academic staff and students. The psychological clinic can be seen as potential structure that could generate income to the institution through psychological services.
4. The lack of an online library with books and articles in the psychology area affects the academic growth of the academic staff and the students.

c. Opportunities

1. Expand the academic programs.
2. Connect and engage with several academic projects, including department academic staff and students with local, national and international institution that they cooperate.
3. The opening of a psychological clinic that would help the cultivation of applicative skills and generate income.
4. Increase of financial sources from projects and the government support, according to the actual law.

d. Threats

1. The system of registering the new system through the electronic-only way, in academic programs or universities might be a problem in understanding the process and/or selecting for many prospective or actual students who want to apply in the school. This misunderstandings might translate into costs and might impair the financial stability of the institution.
2. The competition among similar institutions (IAL) might be seen as a threat in losing staff and faculty.
3. Lack of funds for research from foreign donators.

Grupi i Vlerësimit të Jashtëm:

Dr. Anila Sulstarova

